FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 104

Tiranë – E hënë, 16 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 11.7.2018	Për subvencionimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.....	6497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 11.7.2018	Për miratimin e marrëveshjes së financimit për studime fizibiliteti, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit, në kuadër të studimeve të fizibilitetit për programin e infrastrukturës bashkiake V/programi i investimit dhe i performancës në sektorin e ujit që financohen nga një fond i veçantë nr. 13078, i siguruar nga qeveria Federale Gjermane.....	6497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 427, datë 11.7.2018	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 3.1 ha, që do të përdoret nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor silicor në objektin "Zogasi", Bashkia Skrapar.....	6533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 11.7.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall), të pasurive nr. 241/12, me nr. kadastral 237 e 238 dhe nr. 241/14, me nr. kadastral 239, Njësia Administrative Mollaj, fshati Kamenicë, Bashkia Korçë, për ndërtimin e objekteve të hidrocentralit "Kamenicë"	6536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 11.7.2018	Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet bashkimit të shoqërive, për dhënien me koncesion/partneritet publik privat për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit.....	6536

VENDIM
Nr. 424, datë 11.7.2018

PËR SUBVENCIONIMIN E DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJTARISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 70/2016, "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë për një periudhë njëvjeçare, në masën 35 552 000 (tridhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2018, nga programi buxhetor "Arsimi profesional", artikulli 604, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 426, datë 11.7.2018

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT PËR STUDIME FIZIBILITETI, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (MARRËSI) DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË EKSPERTIT NDAJ MARRËSIT, NË KUADËR TË STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE V/PROGRAMI I INVESTIMIT DHE I PERFORMANCËS NË SEKTORIN E UJIT QË FINANCOHEN NGA NJË FOND I VEÇANTË NR. 13078, I SIGURUAR NGA QEVERIA FEDERALE GJERMANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit për studime fizibiliteti, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e shërbimeve të ekspertit ndaj marrësit, në kuadër të studimeve të fizibilitetit për programin e infrastrukturës bashkiake V/programi i investimit dhe i performancës në sektorin e ujit, që financohen nga një fond i veçantë nr. 13078, i siguruar nga qeveria Federale Gjermane, me një grant në shumën prej 1 950 000.00 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

MARRËVESHJE FINANCIMI
PËR STUDIME FIZIBILITETI, E DATËS 29.5.2018, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË ("MARRËSI") DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW")PËR SHUMËN PREJ 1,950,000.00 EUROSH

Për Shërbimet e Ekspertit ndaj Marrësit, në kuadër të studimeve të fizibilitetit për "Programin e Infrastrukturës Bashkiake V"/Programi i Investimit dhe i Performancës në Sektorin e Ujit (BMZ ID 2013 66 467), i financuar nga një fond i veçantë *(Studien - und Beratungs Fonds)* 13078, i siguruar nga qeveria Federale e Gjermanisë.

Në bazë të autorizimit që i është dhënë nga qeveria Federale Gjermane në datën 25 korrik 2017, Marrësi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të financimit për studime Fizibiliteti.

Neni 1
Shuma dhe Qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një kontribut financiar deri në shumën 1,950,000.00 euro (me fjalë: një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë Euro) ("Kontributi Financiar").

Ky Kontribut Financiar nuk është i shlyeshëm, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi e përdor Kontributin Financiar vetëm për financimin e Shërbimeve të Ekspertëve, si më poshtë:

Mbështetje ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizime (që vepron si Njësi e Koordinimit të Programit NJKP) gjatë përgatitjes së Programit "Infrastruktura Bashkiake V/Programi i Investimit dhe i Performancës në Sektorin e Ujit" ("Programi") nëpërmjet zhvillimit apo përditësimit të studimeve teknike të fizibilitetit për vendndodhjet e përzgjedhura të projekteve ("Shërbimet e Ekspertëve") ("Projekti").

1.3 Marrësi paraqet kontributet e tij homologe plotësisht dhe në kohën e duhur. Marrësi, me kërkesë të KfW-së, siguron të dhëna që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi, si edhe taksat e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2
Disbursimi

2.1 Nëpërmjet Njësisë së Koordinimit të Programit, Marrësi autorizon KfW-në për të kryer pagesat e përkohshme dhe ato përfundimtare nga Kontributi Financiar ndaj konsulentit ("Konsulenti"). Pagesa të tilla kryhen në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertit në bazë të faturave origjinale, që i janë paraqitur KfW-së (kopje për Njësinë e Koordinimit të Programit) dhe në përputhje me Kontratat e Shërbimeve të Konsulencës ("Kontratat Shërbimeve të Konsulencës") që do të lidhen ndërmjet Njësisë së Koordinimit të Programit dhe Konsulentëve. Ky autorizim nga Marrësi, nëpërmjet Njësisë së Koordinimit të Programit, konsiderohet si kërkesë për disbursim për të gjitha pagesat e përmendura më sipër.

2.2 Për pagesat e kryera në valutë ndryshe nga ajo e përcaktuar ("Valuta e huaj"), KfW-ja e debiton Marrësin me një shumë të tillë në euro, siç është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e Valutës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastit.

2.3 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga transferimi në institucione bankare, i disbursimit ose i mbajtjes së pagesave të KfW-së. Nëse shkaktohet ndonjë vonesë nga ana e KfW-së, detyrimi i saj do të kufizohet në pagesën e interesit të shtuar.

2.4 KfW-ja ka të drejtën t'i refuzojë disbursimet pas datës 31 dhjetor 2021.

2.5 Kontratat e Shërbimeve të Konsulencës përfshijnë një dispozitë që përcakton se rimbursimet, garancia ose pagesa të ngjashme të pretenduara dhe pagesa për sigurime kryhen për llogari të Marrësit në llogarinë e KfW-së, Frankfurt am Main, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, BIC: KFWIDEFF, ku KfW-ja krediton pagesa të tilla në llogarinë e Marrësit.

Neni 3
Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund t'i pezullojë disbursimet, përveçse kur:

a) Marrësi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së për kryerjen e pagesave kur ato bëhen të kërkueshme;

b) Janë shkelur detyrimet e kësaj Marrëveshjeje;

c) Marrësi nuk mund të provojë se shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) Përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) Shfaqen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht përmbushjen e qëllimit të Shërbimeve të Ekspertëve;

f) Kontratat e Shërbimeve të Konsulencës që do të lidhen ndërmjet Njësisë së Koordinimit të Programit dhe Konsulentit janë shkelur, kanë përfunduar ose janë anuluar.

3.2 KfW-ja gëzon të drejtën të kërkojë shlyerje të menjëhershme të Kontributit Financiar nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të parashikuara në nenin 3.1 b), c) dhe d) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë. Në rastin e nenit 3.1 c), shlyerja kufizohet në shuma të tilla, pasi Marrësi nuk mund të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e përcaktuar. Në rastin e nenit 3.1 d), shlyerja kufizohet në shuma të tilla, pagesa e të cilave ndaj Marrësit ose marrja e pagesës së tyre nga Marrësi përbëjnë shkelje të ligjit të zbatueshëm.

Neni 4
Kostot dhe pagesat publike

Marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha koston e transfertave dhe koston e konvertimit të kryera në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar.

Neni 5
Deklarimet kontraktuale dhe përfaqësimi

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe persona të caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi përkatës i Marrësit, i autorizuar në atë kohë.

5.2 Çdo ndryshim apo shtesë e kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe duhet të jetë rënë dakord siç duhet ndërmjet të gjitha palëve. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që mbulojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë, nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë duhet të jetë marrë menjëherë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në adresa të tjera të palës kontraktuese përkatëse, siç është njoftuar pala tjetër kontratuese:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin: Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 3,
Tiranë
Faks: +355 42 228494

Neni 6
Shërbimet e ekspertit

6.1 Marrësi:

a) Nëpërmjet NJKP-së, ua ngarkon Shërbimet e Ekspertëve kryesisht Konsulentëve të kualifikuar të pavarur ("Konsulentët") në përputhje me planin e dakordësuar ndërmjet NJKP-së dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve;

b) Nëpërmjet NJKP-së, lidh Kontratën e Shërbimeve të Konsulencës, në përputhje me "Udhëzimet për caktimin e Konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet partnere" (aneksi 1), që është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Për këtë qëllim, KfW-ja pajiset në kohën e duhur me projektkontratën, dokumentet mbi kualifikimet e ekspertëve të zgjedhur dhe të gjithë dokumentacionin tjetër përkatës që mund të kërkojë KfW-ja.

c) Nëpërmjet NJKP-së, siguron financim të plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe, me kërkesë të KfW-së, t'i paraqesë KfW-së dëshmi që vërtetojnë se shpenzimet që nuk janë të paguara në

këtë Kontribut Financiar, janë të mbuluara.

d) Nëpërmjet NJKP-së, ruan dhe mundëson ruajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartë të gjitha kostot në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar;

e) Nëpërmjet NJKP-së, iu mundëson përfaqësuesve të KfW-së që të kontrollojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

f) Nëpërmjet NJKP-së, i ofron KfW-së çdo informacion dhe raport për Shërbimet e Ekspertëve dhe për progresin e tyre të mëtejshëm, me kërkesë të KfW-së;

g) Me pëlqimin e vet, nëpërmjet NJKP-së, informon menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertëve ose qëllimin e tyre;

h) Nëpërmjet NJKP-së, komendon për raportet e Konsulentit ose konfirmon miratimin e tij për përmbajtjen, duke sigluar raportet;

i) nëpërmjet NJKP-së, merr vendimet e saj për të gjitha skicat, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të konsulentëve në marrëveshje me KfW-në;

i) nëpërmjet NJKP-së, monitoron ofrimin e shërbimeve, në përputhje me kontratën e shërbimeve të konsulencës dhe informon menjëherë KfW-në dhe i kërkon asaj të pezullojë pagesat, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të konsulentit, në përputhje me kushtet e kontratës së shërbimeve të konsulencës ose të ndonjë çështjeje tjetër që do të justifikonte pezullimin e pagesës, bazuar në kontratën e shërbimeve të konsulencës.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të komisionimit të Shërbimit të Ekspertëve, KfW-ja pajiset me një sërë kopjesh të të gjitha skicave, raporteve dhe studimeve të hartuara nga konsulenti me kërkesë të KfW-së. KfW-ja mund të kryejë vlerësim të studimeve në fjalë.

6.3 Nga financimi Shërbimeve të Ekspertëve, Marrësi nuk ka të drejtën e financimit të projektit të përgatitur nga Shërbimet e Ekspertëve. Megjithatë, Marrësi i jep Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për financimin e projektit, sipas Bashkëpunimit Financiar, nëse është e nevojshme.

Neni 7

Shërbimet e Konsulentit

7.1 Detyrat e Konsulentëve lidhen me:

- shqyrtimin dhe specifikimin e masave të parashikuara për investime;
- krahasimin e masave teknike alternative;
- analizimin e fizibilitetit teknik të masave të parashikuara për investime;
- inspektimin e sistemeve të kanalizimit (CCTV);
- analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore;
- analizimin e cilësisë së ujit;
- specifikimin e ndikimeve mjedisore dhe klimatike (duke përfshirë aspektet e operimit, përfshirë kostot operative).

7.2 KfW-ja zotëron të drejtën e pakufizuar për të përdorur dhe për të shfrytëzuar rezultatet e Shërbimeve të Ekspertëve dhe të gjitha dokumentet përkatëse të financuara nga Kontributi Financiar, në çdo kohë, dhe në të gjitha vendndodhjet sipas diskrecionit të vet.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve

8.1 Në përputhje me parimet e pranuara në nivel ndërkombëtar për transparencë maksimale dhe efikasitet në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si janë financuar ato gjatë bisedimeve parakontraktuale, ndërsa zbatohen marrëveshjet në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si "Periudha e Plotë").

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e saj të biznesit "Banka e Zhvillimit KfW":
http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja ose palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si janë financuar ato, nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar dhe sensitiv financiar apo në lidhje me biznesin për palët e përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tij, si:

a) Informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) Strategji biznesi;

c) Udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) Të dhëna personale të personave fizikë;

e) Vlerësim i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si financohen gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet:

a) Degët e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) Organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe shifrave të tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si janë financuar ato gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare: http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun: http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO)

c) OECD-ja për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim: http://stats.oecd.org/

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm gjerman për të garantuar transparencë dhe eficiencë: http://www.deval.org/de/

8.4 Gjithashtu, KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën se si financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit përfshijnë, veçanërisht, konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili është përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të ruajtur dhe për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë ose procedime administrative.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Njësia e Koordinimit të Projektit garanton se personat e ngarkuar prej saj me zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve, dhënien e Kontratave për Shërbimet e Ekspertëve që do të financohen dhe me kërkesën për rimbursime të shumave të Kontributit Financiar, nuk kërkojnë, pretendojnë, paraqesin, japin, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 Marrësi, nëpërmjet NJKP-së, nuk hyn në asnjë transaksion ose nuk angazhohet në asnjë veprimtari tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve, e cila do të përbënte një shkelje të embargove që rregullojnë tregtinë e huaj ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian ose Republikës Federale të Gjermanisë.

9.3 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo mangësi që rezulton prej saj do të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.4 Marrësi nuk mund të caktojë ose transferojë, garantojë ose hipotekojë asnjë kërkesë nga kjo Marrëveshje.

9.5 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i kryerjes së shërbimit është Frankfurt am Main.

9.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit përfundojnë 6 vjet pas disbursimit përfundimtar.

9.7 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi menjëherë sapo KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Marrësit se të gjitha procedurat e brendshme ligjore që duhen përmbushur nga Marrësi kanë përfunduar.

Hartuar në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, sot, më . .2018	Tiranë, sot, më 29.5.2018
KfW	Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

ANEKSI 1
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET PARTNERE (FI037122)

BASHKËPUNIMI FINANCIAR
CAKTIMI I KONSULENTËVE
GUSHT 2016
UDHËZIMET PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME VENDET PARTNERE

NDRYSHIMET NË VERSIONIN E MËPARSHËM

Data	Kapitulli	Përmbajtja
1.8.2016	Të ndryshëm	Korrigjimi i gabimeve në shkrim
	1.17c)	Sqarime lidhur me pjesëmarrjen e ofertuesve shtetërorë
	1.17 e)–f)	Përfshirja e nënkontraktuesve
	2.04/2.05	Ndryshim i numërtimit të paragrafëve
	2.06	Sqarime për hapjen e dokumenteve
	2.09/2.22	Shtesa lidhur me sqarimin dhe komunikimin me ofertuesit
	Shtojca 4	Deklaratë e Pranimit të Përgjegjësisë: Sqarime për standardet kryesore të punës, mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë

SHTOJCAT

Fushat e punës për shërbimet e konsulencës	Shtojca 1
Të drejtat e KfW-së për informacion dhe miratim	Shtojca 2
Elementet thelbësore në njoftimin për parakualifikim	Shtojca 3
Deklarata e pranimit të përgjegjësisë	Shtojca 4
Informacione për procesin e parakualifikimit	Shtojca 5
Komponentët përbërës të kërkesës për tendera	Shtojca 6
Komente për vlerësimin e ofertave	Shtojca 7
Kushtet e përgjithshme të kontratës/ Komponentët kryesorë të kontratës së shërbimeve të konsulencës	Shtojca 8
Informacione për kontratat me pagesë të vetme	Shtojca 9
Lista e akronimeve dhe shkurtimeve, dhe fjalorthi	Shtojca 10

Hyrje

Natyra dhe qëllimi i projekteve të mbështetura nga KfW-ja zakonisht nënkuptojnë që Agjencia e Zbatimit të Projektit përfiton nga mbështetja e Konsulentëve vendorë apo ndërkombëtarë, në mënyrë që të përgatiten, zbatohen dhe nëse është e nevojshme, të menaxhohen projektet përkatëse (për detaje rreth fushave të punës për Konsulentët, shihni shtojcën 1). Gjithashtu, Konsulentët mund të caktohen pavarësisht masave të vazhdueshme, si për shembull, për të identifikuar ose për të vlerësuar projektet, ose për të mbikëqyrur masat e trajnimit.

Këto udhëzime ofrojnë informacione për kërkesat minimale gjatë kontraktimit të Konsulentëve[1] në projekte apo programe të mbështetura nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW, duke shfrytëzuar fondet e Bashkëpunimit Financiar Gjerman (FC), fonde të tjera të buxhetit gjerman, fondet e KfW-së ose fonde të donatorëve të tjerë. Këto udhëzime mbështeten në procedurat dhe normat standarde ndërkombëtare.

KfW-ja është përgjegjëse për të gjithë shoqërinë dhe e konsideron qëndrueshmërinë e projekteve dhe të programeve që mbështet si një objektiv gjithëpërfshirës të misionit të saj. Zhvillimi, zbatimi dhe operimi vijues i projekteve dhe i programeve të mbështetura nga departamentet rajonale të KfW-së, duhet të marrin parasysh eficiencën, si edhe aspektet ekologjike dhe sociale. Brenda mundësive të sistemeve partnere, këto aspekte mund të merren parasysh në mënyra të ndryshme për sa i përket përzgjedhjes së firmave/shoqërive dhe/ose në vlerësimin e tenderave.

Në marrëveshjen për hua apo për financim ose në marrëveshjet e tjera ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të projektit dhe KfW-së është rënë dakord për kuadrot e ofrimit të shërbimeve për mbështetjen e projekteve apo të programeve dhe për përzgjedhjen e Konsulentëve. Më pas, detajet e procedurës së ftesës për ofertë paraqiten në njoftimin përkatës të parakualifikimit dhe në kërkesën për tendera. Kjo mundëson fleksibilitetin për sa i përket marrjes në konsideratë të rrethanave specifike të çdo projekti individual. Të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe të Konsulentit paraqiten në kontratën e shërbimeve konsulence që do të nënshkruhet ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe Konsulentit. Për këtë qëllim, KfW-ja ofron një kontratë tip që mbështetet në kontrata tip standarde ndërkombëtare.

Kontratat për shërbime konsulence zakonisht iu jepen institucioneve përgjegjëse për zbatimin e projektit (Klientit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit)[2].

Çfarë është bashkëpunimi financiar?

Bashkëpunimi financiar (FC) është pjesë përbërëse e Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim. Funksioni i tij është të financojë investime në infrastrukturën ekonomike dhe sociale, lehtësimin e varfërisë, mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore në vendet partnere, duke iu ofruar hua, sipas

[1] Termi "konsulent" i referohet një konsulenti individual ose firmave të konsulencës, por në këto udhëzime është i barasvlershëm me një inxhinier konsulence.

[2] Zakonisht, Agjencia e Zbatimit të Projektit është njëkohësisht edhe Klienti. Këta terma përdoren si sinonime në këtë dokument.

termave dhe granteve të favorshëm, duke përdorur fondet e buxhetit federal. Këto fonde mund të plotësohen nga tregu i fondeve të mbledhura nga KfW-ja. Për më tepër, synon t'u mundësojë partnerëve që t'i operojnë shërbimet në mënyrë të pavarur dhe të qëndrueshme përmes masave shtesë bazë dhe të avancuara për trajnim (ngritja e kapacitetit). FC-ja realizohet nga KfW-ja në emër të qeverisë gjermane dhe ministrive të saj, kryesisht në emër të Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ). Fondet e FC-së, ndër të tjera, ndihmojnë në shtimin e furnizimit me ujë dhe energji elektrike, përmirësimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe arsimit, zgjerimin e linjave të transportit dhe nxitjen e prodhimeve bujqësore. Gjithashtu, ata financojnë programe huadhënieje për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për reforma ekonomike dhe për të nxitur programe të ndryshimeve klimatike dhe eficiencën energjetike.

1. Parimet bazë

1.1 Vlefshmëria e udhëzimeve

1.01 Këto udhëzime zbatohen gjatë prokurimit të të gjitha shërbimeve këshilluese dhe të konsulencës që financohen plotësisht ose pjesërisht nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW, duke përdorur fondet e Bashkëpunimit Financiar Gjerman (FC), fonde të tjera gjermane për buxhetin apo fondet e vetë KfW-së. Gjithashtu, ato zbatohen kur supozohet bashkëpunimi i deleguar, përveç rasteve kur bihet dakord me autorizuesin. Udhëzimet zbatohen edhe në rastet kur KfW-ja e lidh kontratën në emrin e saj[3], përveç rasteve kur legjislacioni gjerman parashikon ndryshe.

1.02 Shërbimet e konsulencës sipas Bashkëpunimit Financiar kontraktohen në përputhje me këto udhëzime, përveç kur përcaktohet ndryshe për rastet të veçanta. Në rast se ligji në vendin e Klientit e ndalon zbatimin e këtyre udhëzimeve plotësisht apo pjesërisht, Klienti dhe KfW-ja mund të bien dakord për përjashtimet. Financimi është i mundur vetëm nëse procedurat dhe ligjet ku mbështetet kontrata nuk shkelin parimet bazë të drejtësisë, transparencës, eficiencës ekonomike dhe të mundësive të barabarta që përshkruhen në këto udhëzime. Këto rregullime duhet të kryhen me KfW-n në kohën e duhur.

1.03 KfW-ja mbështet harmonizimin e parimeve dhe procedurave që zbatohen për bashkëpunimin ndërkombëtar të zhvillimit. Si rrjedhojë, në interes të standardizimit, në disa raste përdoren procedurat e organizatave të tjera kompetente dypalëshe dhe shumëpalëshe të zhvillimit, vetëm nëse Klienti është njohur me zbatimin e këtyre procedurave dhe nëse KfW-ja ka dhënë paraprakisht miratimin.

1.2 Përgjegjësia për caktimin e konsulentëve

1.04 Përgjegjësia për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e të gjitha projekteve të financuara nga KfW-ja i ngarkohet Klientit përkatës në vendin partner, përveç rasteve kur KfW-ja e ka dhënë kontratën në emër të saj. Zakonisht, Klienti e zhvillon të gjithë procedurën e kontraktimit, e nënshkruan kontratën dhe mbikëqyr performancën kontraktuese të Konsulentit në mënyrë të pavarur.

Gjithashtu, përgjegjës është edhe Klienti në rastet kur KfW-ja, në mënyrë të veçantë, zhvillon procedurën e përzgjedhjes për dhe në emër të Klientit, sipas parimeve të agjencisë (shihni pikën 1.10).

1.05 Gjatë zbatimit të procedurës së kontraktimit, Klienti, me miratimin e KfW-së, mund të mbështetet nga një agjent tenderash dhe mund t'i delegojë këtij agjenti pjesë të procedurës (përgatitjen e dokumenteve të tenderimit, publikimin, vlerësimin e ofertave, negociatat kontraktuese) ose të gjithë procesin. Agjenti i tenderit është i detyruar që të ruajë konfidencialitetin. Kjo nuk ndikon përgjegjësinë e Klientit, në përputhje me paragrafin 1.04 apo të detyrimeve të KfW-së për të dhënë miratimin në përputhje me paragrafin 1.08.

1.3 Roli i KfW-së

1.06 KfW-ja ka një rol aktiv në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve që financon. Detyra e saj në ushtrimin e kujdesit të duhur nënkupton që të ketë ndikim te projekti, në mënyrën e duhur, duke marrë parasysh çështjen në shqyrtim për të shmangur zhvillime të pafavorshme që mund të shfaqen gjatë fazave të planifikimit, zbatimit apo operimit. Ky ndikim do të ushtrohet në formën e dialogut bashkëpunues me Klientin.

[3] Këtu përfshihen edhe procedurat e kontraktimit, ku KfW-ja vepron si pjesë e konsorciumit.

1.07 KfW-ja siguron që fondet e vëna në dispozicion të shpenzohen në mënyrë sa më ekonomike që të jetë e mundur. Ajo do të sigurojë që kontratat të lidhen në mbështetje me konkurrencën e drejtë dhe transparente që ofron mundësi të barabarta për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës. Kjo kryhet për të identifikuar ofertuesin më të përshtatshëm, mbështetur në performancën e tyre dhe çmimin e ofruar. Gjithashtu, KfW-ja do të shqyrtojë dokumentet e tenderimit, raportet e vlerësimeve, propozimet për dhënien e kontratës dhe projektkontratat që duhet të paraqiten si pjesë e procedurës së kontraktimit, në mënyrë që të sigurohet se ato janë në përputhje me marrëveshjet e bëra me Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe me praktikat ndërkombëtare, veçanërisht për sa i përket përshkrimit të shërbimeve, mënyrave të pagesës, përgjegjësive dhe garancive dhe që të sigurohet se draftet nuk kanë të meta apo kundërshtime. Së fundi, KfW-ja do të vlerësojë operimin nga ana e Klientit për përmbushjen e kontratave nga kontraktuesi gjatë fazës së zbatimit.

1.08 Nevojitet miratimi paraprak nga KfW-ja[4] për publikimin e të gjitha dokumenteve për Deklaratën e Interesit dhe Ftesën për Ofertë[5], zgjedhjen e Konsulentit dhe projektkontratës së shërbimeve të konsulencës. Krahas kësaj, nevojitet miratimi paraprak i KfW-së edhe për ndryshime në kontratë dhe për pranimin e shërbimeve të konsulencës nga Klienti. Një listë me procedurat që duhen ndjekur dhe dokumentet që duhet t'i paraqiten KfW-së gjendet në shtojcën 2.

1.09 KfW-ja mund të refuzojë financimin e shërbimeve të konsulencës, si edhe të gjithë projektin e FC-së, në rast se nuk është bërë zgjedhja në përputhje me procedurat e rëna dakord, nëse kualifikimet e Konsulentit nuk përputhen me specifikimet e tenderit, nëse termat e kontratës së shërbimeve të konsulencës nuk përputhen me kërkesat minimale, nëse procedurat e përzgjedhjes janë ndikuar nga pagesa të jashtëligjshme, nga dhënia ose premtimi i avantazheve të tjera, ose nëse rrethanat sugjerojnë që është ushtruar një ndikim i tillë.

1.10 Me kërkesë të Klientit, në raste të veçanta KfW-ja mund të zhvillojë të gjithë ose pjesë të procedurës së përzgjedhjes dhe ta autorizojë Konsulentin për dhe në emër të Klientit. Për këtë arsye, KfW-ja do të nënshkruajë një kontratë agjenti me Klientin, duke deklaruar kohëzgjatjen dhe detajet e shërbimeve që do të ofrohen nga KfW-ja. Shërbimet e ofruara nga KfW-ja sipas kësaj kontrate agjenti janë falas. Zakonisht, kjo kontratë përfundon kur nënshkruhet kontrata e shërbimeve të konsulencës nga KfW-ja për dhe në emër të Klientit. Këto udhëzime zbatohen në të tilla raste.

1.11 Gjithashtu, në raste të përshtatshme, KfW-ja mund të japë kontrata për shërbime konsulence në emrin e saj. Në këto raste, zbatohen këto udhëzime, përveç rastit kur dispozitat e legjislacionit gjerman për prokurimin publik e pengojnë këtë.

1.4 Ftesa publike, e drejtë dhe transparente për ofertë

1.12 Zakonisht, Klienti publikon një ftesë ndërkombëtare për ofertë për shërbimet e konsulencës. Në këtë rast, nuk ka kufizime për sa i përket vendit të origjinës së ofertuesit, përveç rasteve kur ka kufizime të miratuara në raste të caktuara apo kur zbatohen arsyet për përjashtim, të përcaktuara në seksionet 1.6 dhe 1.7.

1.13 Kufizimet për parimin e ftesës publike ndërkombëtare për ofertë, të përshkruara në seksionin 2.1, janë të mundura vetëm pas miratimit paraprak të KfW-së, në rastet e garantuara apo në formën e prokurimeve të parashtruara në seksionet 3 dhe 4.

1.14 Kërkohet që të gjithë pjesëmarrësit në një ftesë për ofertë për shërbimet që do të financohen plotësisht apo pjesërisht nga KfW-ja të sigurojnë konkurrencë të drejtë dhe transparente dhe të jenë në përputhje minimale me standardet bazë të punës sipas ILO-së, të cilat janë ratifikuar nga vendi partner. Kjo do të

[4] Nëse ftesa të shumta për të njëjtën ofertë planifikohen duke përdorur dokumente uniforme për të cilat është rënë dakord paraprakisht me KfW-në, shqyrtimi i ndarë i dokumenteve mund të zëvendësohet nga shqyrtimi i dokumenteve standarde të tenderave që kryhet vetëm një herë.

[5] Nëse parashikohet një numër i madh i procedurave kontraktuese mjaft të detajuara, mund të mos nevojitet miratimi paraprak, vetëm nëse është rënë paraprakisht dakord me KfW-në për rregullat e kontraktimit, detyrimet e dokumentacioneve dhe kur çmohet i nevojshëm shqyrtimin pasues nga KfW-ja ose një përfaqësues (p.sh., në rast të fondeve në natyrë dhe ftesave vendore për ofertë).

dokumentohet nëpërmjet një deklarate përkatëse për sipërmarrjen (shihni Shtojcën 4) nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces tenderimi. Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë duhet të nënshkruhet, duke pasur efekt ligjor nga përfaqësues të autorizuar të ofertuesit dhe nga të gjithë partnerët, në rast të ofertave të përbashkëta. Në rast se nuk dorëzohet Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë apo nëse nuk respektohen kërkesat e përcaktuara në të, kjo sjell përjashtimin nga procesi i tenderimit.

1.5 Konfidencialiteti

1.15 Procesi i përzgjedhjes është konfidencial. Rrjedhimisht, megjithëse procesi është i vazhdueshëm, as Klienti dhe as KfW-ja nuk do të publikojnë asnjë informacion për vlerësimin e ofertave apo rekomandimet për dhënien e kontratës ofertuesve apo personave të tjerë që nuk janë përfshirë zyrtarisht në procedurën e përzgjedhjes. Nëse shkelet detyrimi i konfidencialitetit, KfW-ja mund të kërkojë përfundimin e ftesës për ofertë.

1.16 Nuk lejohen diskutimet me ofertuesit për ofertat e tyre ndërmjet kohës së publikimit të ftesës për ofertë dhe dhënies së kontratës. Përjashtime janë vetëm vizitat në terren në mënyrë që të merren informacione, pjesëmarrja në një takim me ofertues të përzgjedhur paraprakisht apo inspektimi i dokumenteve të disponueshme. Këto komunikime bëhen me qëllimin e vetëm për të njohur ofertuesit me kushtet vendore dhe me dokumentet e disponueshme të punës. Përpos këtyre, lejohen vetëm kërkesat me shkrim për sqarim.

Klienti do t'u kthejë përgjigje me shkrim kërkesave të tilla dhe të gjithë ofertuesve do t'u dërgohet një kopje. Kërkesa apo ndërhyrje të tjera janë të ndaluara dhe në rast se shkelen, ofertuesi do të përjashtohet (shihni seksionin 2.8 lidhur me njoftimin e ofertuesve pas përfundimit të procedurës).

1.6 Ofertuesit me të drejtë pjesëmarrjeje në procedurë

1.17 Ofertat e ofertuesve do të bëhen pjesë e procedurës vetëm nëse asnjë nga arsyet e mëposhtme për përjashtim apo konflikt interesi nuk vlen për ta:

a) Sanksione apo embargo nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, E-ja apo qeveria gjermane që pengojnë pjesëmarrjen e një ofertuesi;

b) Ofertuesi përjashtohet ligjërisht nga procesi i tenderimit në vendin e Klientit për shkak të një shkeljeje të ndëshkueshme, veçanërisht mashtrim, korrupsion apo krime të tjera ekonomike;

c) Ofertuesi është një shoqëri shtetërore në vendin partner, që nuk është e pavarur ligjërisht apo ekonomikisht, apo që nuk është subjekt i së drejtës tregtare, apo që është një autoritet publik në varësinë e Klientit apo Agjencisë së Zbatimit të Projektit, apo marrës i huas/kontributit financiar;

d) Ofertuesi apo anëtarë specifikë të stafit të ofertuesit apo një nënkontraktues ka lidhje ekonomike apo familjare me ndonjë nga personeli i Klientit që merret me përgatitjen e dokumenteve të tenderit, dhënien e kontratës apo mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, aq sa konfliktet e interesit të mos zgjidhen sipas kërkesës së KfW-së përpara dhënies së kontratës dhe fazës së zbatimit;

e) Ofertuesi apo anëtarë specifikë të personelit të ofertuesit apo nënkontraktuesi është i lidhur drejtpërdrejt me hartimin e termave të referencës dhe/ose informacioneve të tjera për procesin e tenderimit. Kjo nuk është e zbatueshme për Konsulentët që kanë krijuar studime përgatitore për kontratën apo që kanë qenë të përfshirë në një fazë të mëparshme, aq sa informacioni që ata kanë përgatitur lidhur me këtë, veçanërisht lidhur me studimet e fizibilitetit, ishte i disponueshëm për të gjithë ofertuesit dhe përgatitja e termave të referencës për ftesën për ofertë nuk ishte pjesë e veprimtarisë;

f) Ofertuesi ose anëtarë specifikë të personelit të ofertuesit apo nënkontraktuesi nuk janë ose nuk kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt ose jo, gjatë 12 muajve të fundit para publikimit të ftesës për ofertë, në projektin në fjalë përmes punësimit si anëtar personeli ose këshillues i Klientit dhe nuk janë ose nuk kanë ndikuar me anë të kësaj lidhjeje në dhënien e kontratës për shërbimet, ose ofertuesi nuk ndikon, ose nuk ka ndikuar në dhënien e kontratës për shërbime.

Duke nënshkruar Deklaratën e Sipërmarrjes (shihni shtojcën 4), ofertuesi pohon se asnjë prej këtyre arsyeve për përjashtim apo konfliktet e interesit nuk është e vlefshme. Në rast dyshimi, gjatë tenderimit, ofertuesi në fjalë paraqet prova për Klientin dhe KfW-në që vërtetojnë se arsyet e lartpërmendura nuk janë të vlefshme për të.

1.7 Pavarësia e Konsulentit

1.18 Konsulenti duhet të jetë gjithmonë i

paanshëm dhe i pavarur për sa i përket furnitorëve të mundshëm të projektit në fjalë. Anëtarët e firmave/shoqërive vartëse mund të marrin pjesë në një projekt vetëm si firma/shoqëri konsulence apo prodhimi/ furnizimi/ndërtimi. Kur dorëzojnë propozimet, Konsulentët duhet të tregojnë lidhjet që mund të kenë me firma/shoqëri të tjera ose të japin një deklaratë shtrënguese që përcakton se nëse kontrata iu jepet atyre, firmat/shoqëritë me të cilat janë të lidhura, nuk do të marrin pjesë në projekt në forma të tjera. Në sipërmarrje të përbashkëta kjo është e zbatueshme edhe për profesionistët pjesëmarrës dhe firmat e tjera të konsulencës. Këto rregulla nuk zbatohen për projektet "Ndërto-Opero-Transfero" (BOT) apo modelet e operatorit.

1.19 Firmat/shoqëritë e konsulencës që i përkasin të njëjtit grup shoqërish apo shoqërive me veprimtari të ngjashme apo që janë të lidhura financiarisht, në mënyrë organizative apo përmes personelit, mund të marrin pjesë individualisht në procedurën konkurruese të tenderimit, vetëm nëse nuk merr pjesë asnjë anëtar tjetër i grupit apo i shoqërisë.

1.8 Bashkëpunimi ndërmjet ofertuesve

1.20 Konsulentët mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese të tenderimit si shoqëri të çdo lloj forme ligjore dhe së bashku me Konsulentë të tjerë. Pas përfundimit të procedurës së parakualifikimit, bashkëpunimi ndërmjet Konsulentëve të parakualifikuar lejohet vetëm me miratimin e Klientit dhe KfW-së dhe vetëm nëse vazhdon të garantohet konkurrenca e mjaftueshme.

1.21 Në projektet e financuara nga KfW-ja, rëndësi e veçantë i jepet bashkëpunimit me ekspertë ose shoqëri që kanë një historik, për sa i përket përvojës vendore dhe ndërkombëtare. Bashkëpunime të tilla mund të bëhen të detyrueshme në njoftimin e parakualifikimit apo kërkesën për ofertë. Renditja dhe përzgjedhja e ekspertëve dhe e firmave të konsulencës në fjalë janë në diskrecion vetëm të ofertuesit. Klienti nuk mund të kërkojë bashkëpunim me ekspertë të caktuar vendorë, firma apo grup firmash.

1.22 Nëse propozohet një bashkëpunim i tillë, dokumentet e dorëzuara për procesin e parakualifikimit duhet të përmbajnë informacionet e nevojshme për të gjithë partnerët e synuar. Në veçanti, duhet të përfshijnë një përshkrim shtrëngues të kompetencave të tyre, fushave të punës dhe llojin e bashkëpunimit që do të ketë. Dokumentet duhet të përfshijnë një deklaratë qëllimi, të nënshkruar nga të gjithë partnerët dhe një deklaratë që përcakton se cila firmë konsulence do të drejtojë punën. Nëse atyre iu jepet kontrata, partnerët ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për kryerjen e punës së përshkruar në dokumente dhe në mënyrën e bashkëpunimit të përcaktuar. Grupeve të ofertuesve[6] iu kërkohet që të nënshkruajnë një marrëveshje me përgjegjësi të përbashkët dhe të shumëfishtë. Në raste të veçanta (p.sh., projekte të mëdha), kërkesa për ofertë mund të kërkojë një prezantim të detajuar dhe një marrëveshje shtrënguese ndërmjet partnerëve të një grupi (p.sh., në formën e një kontrate paraprake).

1.9 Kontrata

1.23 KfW-ja do të ofrojë një kontratë tip[7] që përcakton standardet për përmbajtjen dhe kërkesat formale për kontratat e shërbimeve të konsulencës dhe që duhet të përdoren kudo që të jetë e mundur. Për aq kohë sa palët e kontratës shmangen nga kjo, kontratat për shërbimet e konsulencës përgatiten në bazë të praktikave dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht. Përfshin të paktën dispozitat e përcaktuara në Shtojcën 8. Nëse projektkontrata nuk bashkëlidhet në dokumentet e tenderit, atëherë marrëveshjet kryesore kontraktuese që drejtojnë ose ndikojnë në kosto renditen të ndara në tekstin e ftesës për ofertë.

1.24 Klienti, në bashkëpunim me KfW-në, mund të bjerë dakord me Konsulentin për shpërblimin, mbështetur ose në punën e kryer, ose në bazë të pagesës së vetme. Shpërblimi i mbështetur në punën e kryer rekomandohet në rast se puna që do të kryhet nga Konsulenti nuk është përcaktuar përfundimisht para negociatave kontraktuese, si për shembull, detyrat për menaxhimin e ndërtimeve. Do të bihet dakord për shpërblimin e pagesës së vetme, nëse janë përcaktuar qartë shërbimet që do të ofrohen dhe periudha kohore brenda së cilës do të ofrohen. Do t'i jepet përparësi shpërblimit të pagesës së

[6] Konsorciume, ndërmarrje të përbashkëta etj.

[7] Kontrata tip është në dispozicion në faqen e internetit të KfW-së (www.kfw.de).

vetme për studime, planeve të detajuara dhe shërbimeve të tjera që mund të përcaktohen po aq qartë. Për kontratat e pagesës së vetme, mjafton që të bihet dakord në mënyrë kontraktuese vetëm për personelin kyç (për detaje të mëtejshme lidhur me kontratën e pagesës së vetme në shtojcën 9).

2. Procedura e Ftesës Ndërkombëtare Publike për Ofertë

2.1 Parimi kryesor, publikimi dhe afatet

2.01 Procedura e prokurimit për shërbime konsulence zakonisht përfshin një ftesë ndërkombëtare, publike, të pakufizuar për oferta, të zhvilluar në dy faza, përkatësisht parakualifikimi dhe tenderimi konkurrues, sipas seksioneve 2.2 dhe 2.3. Në fazën e parë të procedurës vlerësohet përshtatshmëria e përgjithshme e ofertuesve[8]; në fazën e dytë zhvillohet një konkurs ndërmjet ofertuesve të parakualifikuar për të përzgjedhur ofertuesin, i cili ka paraqitur ofertën më të mirë lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe çmimin e tyre përkatës.

2.02 Devijimi nga kjo procedurë dyfazore është i mundur vetëm me miratimin e KfW-së, veçanërisht në ato raste të specifikuara në paragrafin 2.13. Publikimi ndërkombëtar i ftesës për ofertë mund të hiqet në rastet e përcaktuara në seksionin 3.

2.03 Ftesa ndërkombëtare, publike dhe e pakufizuar për ofertë do të publikohet në media me shtrirje ndërkombëtare dhe në vendin partner. Publikimi do të fillohet nga Klienti. Publikimi ndërkombëtar i ftesës për ofertë duhet të përfshijë të paktën kanalet e Tregtisë dhe Investimit Gjerman[9] (GTAI). Ky publikim do të jetë pa pagesë. Klienti do t'i sigurojë pa pagesë GTAI-së tekstin e njoftimit dhe një grup të plotë të dokumenteve të tenderit. Publikimi në vendin partner do të bëhet në përputhje me rregulloret vendore të zbatueshme për Klientin. Ftesa për ofertë nuk mund të publikohet në vendin partner apo diku tjetër përpara se të jetë publikuar nga GTAI-ja.

Klienti do t'i dërgojë KfW-së tekstin e njoftimit dhe përshkrimin e shërbimeve të kërkuara (termat e referencës) për miratim në kohën e duhur përpara publikimit. Afatet për përgatitjen e dokumenteve të parakualifikimit dhe përgatitjen e ofertave duhet të marrin në konsideratë rrethanat e veçanta të projektit, masën dhe kompleksitetin e tij dhe të sigurojnë konkurrim të mjaftueshëm dhe transparent. Afatet duhet të jenë të paktën 30 ditë kalendarike për procedurat e parakualifikimit dhe 45 ditë kalendarike për ofertat.

2.04 Afatet për përgatitjen e dokumenteve të parakualifikimit dhe përgatitjen e ofertave duhet të marrin në konsideratë rrethanat e veçanta të projektit, masën dhe kompleksitetin e tij dhe të sigurojnë konkurrim të mjaftueshëm dhe transparent. Afatet duhet të jenë të paktën 30 ditë kalendarike për procedurat e parakualifikimit dhe 45 ditë kalendarike për ofertat. Afatet mund të shtyhen vetëm në raste të veçanta. Të gjithë ofertuesit duhet të njoftohen për shtyrjen e afatit me shkrim pasi KfW të ketë marrë njoftimin paraprak, në kohën e duhur përpara përfundimit të afatit fillestar.

Të gjithë ofertuesit do të njoftohen me shkrim, njëkohësisht dhe në një kohë të përshtatshme, jo më vonë se 14 ditë kalendarike nga përfundimi i afatit për dorëzimin e ofertave, për përgjigjet e Klientit, lidhur me çështjet e ngritura nga ofertues individualë përpara përfundimit të afatit për dorëzim.

2.05 Dokumentet e parakualifikimit dhe ofertat do të dorëzohen në formë të shkruar dhe elektronike, si skedarë PDF-je në media standarde elektronike. Mjetet për ruajtjen e informacionit duhet të paketohen në zarfe të ndara (shihni 2.12). Skedarët elektronikë nuk duhet të lejojnë ndryshimin e përmbajtjes së ruajtur. Dorëzimi i dokumenteve në formë elektronike është i mundur me miratimin paraprak të KfW-së, duke përdorur platformën elektronike të prokurimit që garanton konfidencialitetin e procedurës.

2.06 Dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi do të hapen sa më afër datës së dorëzimit të tyre dhe, përveçse kur parashikohet ndryshe në detaje - në praninë e të paktën një dëshmitari (parimi i kontrollit të dyfishtë). Përpara hapjes së dokumenteve do të përgatitet një procesverbal, i cili i bashkëngjitet raportit të vlerësimit dhe

[8] Termi "ofertues" dhe termi "aplikant" përdoren në vend të njëri-tjetrit me të njëjtin kuptim.

[9] Emri i plotë: Tregtia dhe Investimi Gjerman – *Gesellschaft für Außenwirtschaft und Standortmarketing mbH*; faqja e internetit: www.gtai.de, për detaje të adresës së plotë, shihni shtojcën 3.

nënshkruhet nga të gjithë personat e pranishëm gjatë hapjes së dokumenteve. Nëse procedura e prokurimit kërkon që dokumentet të dorëzohen në zarfe të veçanta (si, p.sh., propozimi i veçantë teknik dhe kuotimi i çmimeve) do të mbahet një procesverbal për çdo seancë të hapjes për vlerësimin e tyre. Procesverbali raporton nëse dokumenti ishte i vulosur në mënyrën e duhur, nëse ishte dorëzuar në kohë, si dhe çmimin e ofertës pa e kontrolluar.

2.2 Parakualifikimi

2.07 Procedura e parakualifikimit përfshin shqyrtimin, në bazë të dokumenteve të parakualifikimit të dorëzuara në format të qartë, informues dhe të saktë, nëse ofertuesit janë në gjendje të kryejnë siç duhet shërbimet e kërkuara të konsulencës. Kriteret kryesore që do të merren parasysh janë:

a) Mungesa e kritereve përjashtuese sipas seksioneve 1.6 dhe 1.7;

b) Përvoja në zbatimin e projekteve të ngjashme në sektorin përkatës, zakonisht jo më pak se pesë vitet e fundit;

c) Përvoja në vendin partner ose vende të ngjashme, zakonisht jo më pak se pesë vitet e fundit;

d) Burime financiare dhe ekonomike dhe ekspertiza (në lidhje me masën e kontratës në fjalë);

e) Burime dhe kapacitete njerëzore, duke përfshirë kapacitete mbështetëse, nëse është e nevojshme, të plotësuara me burime të jashtme për aktivitetet e parashikuara;

f) Dorëzimi i Deklaratës së Sipërmarrjes nga ofertuesi, të nënshkruar me efekt ligjor në përputhje me shtojcën 4.

2.08 Kërkesat minimale për t'u kualifikuar për detyrën, si dhe skema e vlerësimit të parakualifikimit (për detaje dhe shpjegime të mëtejshme shihni shtojcat 3 dhe 5) do të publikohen në njoftimin e parakualifikimit.

2.09 Vetëm ofertuesit të cilët marrin të paktën 70% të pikëve do të përzgjidhen. Nëse më shumë se pesë ofertues arrijnë atë total, do të përzgjidhen pesë ofertuesit me numrin më të madh të pikëve. Parakualifikimi kërkon miratimin e KfW-së. Për këtë qëllim, Klienti i dërgon KfW-së Raportin e Vlerësimit për parakualifikimin dhe të gjitha dokumentet e kërkuara në kohën e duhur. Raporti përmban të gjitha sqarimet dhe komunikimet me ofertuesit.

2.10 Pasi KfW-ja të ketë konfirmuar rezultatin e parakualifikimit, Klienti do të informojë ofertuesit mbi rezultatin. Me kërkesë të ofertuesit, Klienti mund të japë shkurtimisht arsyet kryesore për përjashtimin e ofertës. Megjithatë, nuk do të zbulohen detaje mbi procedurën e vlerësimit apo informacion mbi ofertat konkurruese. Ofertuesit nuk kanë të drejtë ankimi, përveç të drejtave të parashikuara në ligjet e vendit partner. Ofertuesit e përzgjedhur do të informohen mbi firmat e tjera konsultuese të parakualifikuara.

2.3 Faza e tenderimit

2.11 Klienti do të ftojë Konsulentët e parakualifikuar të paraqesin një ofertë dhe do t'u dërgojë atyre një përshkrim të shërbimeve që duhet të kryhen (termat e referencës), informacion shtesë lidhur me projektin që u nevojitet ofertuesve për të përgatitur oferta të bazuara teknike dhe financiare, si dhe të dhënat financiare përkatëse të draftkontratës (detajet mbi ftesën për ofertë jepen në shtojcën 6). Termat e referencës do të parashikojnë nëse shpërblimi do të jepet në bazë të punës së kryer apo si një pagesë e plotë. Në rastin e një pagese të plotë, termat e referencës do të përcaktojnë pozicionet e personelit të konsideruara kyçe që do të përshkruhen hollësisht në propozimin teknik. Klienti do t'i dorëzojë KfW-së dokumentet e ofertës për miratim në kohën e duhur përpara publikimit.

2.12 Oferta teknike dhe financiare do të dorëzohen të ndara në dy zarfe të mbyllura dhe të vulosura. Një origjinal i secilit duhet t'i dërgohet Klientit apo një përfaqësuesi të caktuar prej tij dhe një kopje i dërgohet KfW-së, në adresat e përcaktuara dhe në afatin e vendosur në kërkesën për ofertë. Pas asaj date nuk mund të kryhen ndryshime apo plotësime të ofertave. Çdo përpjekje çon në përjashtimin e ofertuesit nga pjesa e mbetur e procesit të seleksionimit. Ofertat për shërbime do të hapen menjëherë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

Zarfet që përmbajnë kuotimet e çmimeve do të qëndrojnë të mbyllura dhe do të hapen vetëm me miratimin e KfW-së, për ata ofertues që kanë arritur të paktën 75% të pikëve të dhëna në vlerësimin e ofertave për shërbime.

2.13 Procedura dyfazore mund të hiqet me miratimin e KfW-së, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) Vlera neto e parashikuar e kontratës është nën 200,000 euro; ose

b) Për shkak të veprimtarisë në shkallë të ulët në këtë treg nuk pritet të ketë më shumë se pesë oferta; ose

c) Për shkak të kufizimeve në kohë, zbatimi i procedurës dyfazore mund të ndikojë negativisht në projekt.

Në këtë procedurë me një fazë (pas kualifikimit), do të dorëzohen njëkohësisht dokumentet kualifikuese, propozimi teknik dhe kuotimi i çmimit. Përshtatshmëria e ofertuesve do të vlerësohet në përputhje me kriteret specifike të projektit të parashikuara në seksionin 2.2, ndërsa propozimi teknik dhe kuotimi i çmimit vlerësohen në përputhje me seksionin 2.4. Kur vlera e kontratës është e ulët dhe/apo tregu njihet mirë, shqyrtimi i përshtatshmërisë së ofertuesve mund të kufizohet në disa kritere përjashtimi të qarta (si, p.sh., minimumi i përvojës/i referencave në projekt dhe xhiro minimale) dhe ky shqyrtim do të kryhet përpara vlerësimit të propozimit teknik. Kuotimi i çmimit që dorëzohet në një zarf të veçantë hapet dhe shqyrtohet pasi KfW-ja të ketë miratuar vlerësimin e përshtatshmërisë dhe propozimin teknik.

2.4 Vlerësimi i ofertave

2.14 Pas hapjes së ofertave, ato do të shqyrtohen në mënyrë formale për të përcaktuar nëse janë të plota, nëse plotësojnë kushtet e ftesës për ofertë dhe nëse garancitë dhe deklaratat e dhëna nga ofertuesi përputhen me dokumentet e tenderit. Hapja e ofertave duhet të bëhet në praninë e të paktën dy personave dhe duhet të dokumentohet me shkrim për t'u nënshkruar nga personat e pranishëm.

2.15 Vlerësimi i ofertave, që nuk janë refuzuar sipas paragrafit 2.14 dhe seksionit 2.5, kryhet normalisht nga Klienti, me mbështetjen e një agjenti prokurimi. Për kontratat e reklamuara nga KfW-ja në emër të saj, ofertat do të vlerësohen nga KfW-ja. Qëllimi i vlerësimit është identifikimi ofertës më të favorshme, duke vlerësuar faktorët përkatës në secilën prej ofertave dhe duke i krahasuar me ofertat e tjera.

2.16 Ofertat për shërbime do të vlerësohen në bazë të një liste kriteresh paraprakisht të përcaktuar (detajet dhe shpjegimet jepen në anekset 6 dhe 7). Për t'i mundësuar KfW-së ushtrimin e së drejtës për miratim, Klienti duhet t'i dërgojë KfW-së Raportin e Vlerësimit mbi Ofertat për shërbime në kohën e duhur, së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara nga KfW.

2.17 Në parim, kuotimet e çmimeve do të vlerësohen duke përdorur çmimin total (pa përfshirë doganën, akcizat, tatimet dhe taksat në vendin e Klientit), pas korrigjimit të ndonjë gabimi aritmetik. Shpenzimet e rastit dhe shërbimet shtesë që paguhen veçmas, në bazë të provave, në përputhje me kushtet e ftesës për ofertë mund të përshtaten për qëllime të vlerësimit apo të përjashtohen nga vlerësimi, nëse kjo është e vetmja mënyrë për të krahasuar kuotimet e çmimit. Ofertat opsionale të shërbimeve do të përfshihen në vlerësimin e kuotimeve të çmimeve vetëm nëse të gjithë ofertuesve u është kërkuar të dorëzojnë oferta të tilla në përputhje me kushtet e ftesës për ofertë.

2.18 Nëse gjatë vlerësimit vërehen mospërputhje ndërmjet propozimit teknik dhe kuotimit të çmimit, duhet të qartësohet me ofertuesin, pasi kjo nuk mund të ndryshojë apo të përmirësojë ofertën origjinale. Kostot që sipas formulimit të ftesës për ofertë do të ofrohen veçmas, por nuk janë evidentuar veçmas në ofertë do të vlerësohen me çmimin më të lartë të kostos së ofertuesve të tjerë.

Hapat e ndërmarrë për të llogaritur çmimin total të rregulluar do të shpjegohen hollësisht nga Klienti në Raportin e Vlerësimit.

2.19 Kuotimi i çmimit në përgjithësi do të përbëjë 30% të vlerësimit të përgjithshëm. Një koeficient i ndryshëm kërkon miratimin e KfW-së (si, p.sh., një koeficient më i madh në rastin e mbikëqyrjes së ndërtimit apo një peshë më e vogël në rastin e shpalljes së buxhetit në dispozicion për dokumentet e ofertës).

2.20 Kuotimi i çmimit me vlerën totale më të ulët, të rregulluar do të marrë numrin maksimal të pikëve (përgjithësisht 30). Numri i pikëve të dhëna për kuotimet e tjera të çmimeve arrihet duke e pjesëtuar çmimin total të rregulluar në ofertën më të ulët me çmimin total të rregulluar të secilës ofertë dhe, më pas, duke e shumëzuar me numrin maksimal të mundshëm të pikëve.

2.21 Oferta për shërbime me vlerësimin më të lartë do të marrë numrin maksimal të pikëve (në përgjithësi 70). Numri i pikëve të dhëna për

ofertat e tjera për shërbime arrihet duke pjesëtuar vlerësimin e secilit me vlerësimin e ofertës më të lartë për shërbime dhe më pas duke e shumëzuar me numrin maksimal të mundshëm të pikëve. Numri i pikëve të dhëna për kuotimin e çmimit do t'i shtohet numrit të dhënë për ofertën e shërbimeve. Renditja e ofertuesve do të përcaktohet nga numri total i pikëve. Oferta me numrin total më të lartë të pikëve do të pranohet si më e mira.

2.22 Pas përfundimit të vlerësimit, KfW-ja do të marrë nga Klienti një raport të hollësishëm dhe transparent mbi vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ("Raporti i Vlerësimit"), së bashku me një propozim të arsyetuar për dhënien e kontratës, që mund të jetë diskutuar dhe rënë dakord me agjencitë qeveritare të vendit partner përkatës. Raporti do të përfshijë të gjitha sqarimet dhe komunikimin me ofertuesit. Ky Raport Vlerësimi do të rendisë në detaje pikat e rëndësishme për negociata të mundshme kontraktuese për ofertuesit e renditur në tri vendet e para. Në rast se Klienti mbështetet nga një agjent tenderi (paragrafi 1.05), Raporti i Vlerësimit do të bashkënënshkruhet nga agjenti apo do t'i bashkëngjiten komentet e veçanta të agjentit mbi raportin. Propozimi për dhënien e kontratës do t'i paraqitet KfW-së për miratim.

2.23 Nëse ka qenë e nevojshme zgjatja e periudhës së vlefshmërisë së ofertave, arsyet kryesore do të shpjegohen në Raportin e Vlerësimit. Zgjatja e periudhës së vlefshmërisë nuk duhet të ndryshojë çmimet e kuotuara në oferta. KfW-ja rezervon të drejtën për të refuzuar financimin në rast vonesash të papërshtatshme të procedurës kontraktuese.

2.5 Refuzimi i ofertave

2.24 Ofertat do të refuzohen në parim nëse:

a) Konsulenti ka ndikuar apo ka synuar të ndikojë në procedurën e përzgjedhjes me pagesa të paligjshme apo duke dhënë apo premtuar avantazhe të tjera, apo nëse rezulton nga rrethanat se është ushtruar një ndikim i tillë;

b) Oferta është pranuar në vendin e specifikuar të shpalljes pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave, përveç kur ofertuesi mund të dëshmojë se nuk është përgjegjës për vonesën, e cila është shkaktuar nga një forcë madhore (vonesat në dërgim nga shërbimet postare nuk përbëjnë forcë madhore);

c) Oferta nuk i plotëson kriteret në pikat thelbësore të ftesës për ofertë, siç janë kushtet e përcaktuara të kontratës apo specifikimet kyçe;

d) Oferta përmban dispozita ose kufizime të konsiderueshme;

e) Deklarata e ofertuesit që lidhet me shoqëri të tjera nuk tregon qartë nëse ai apo ky i fundit nuk do të aplikojnë për të marrë pjesë në të njëjtin projekt si prodhues, furnizues apo firma ndërtimi;

f) Ofertuesi nuk ka dorëzuar Deklaratën e Sipërmarrjes të nënshkruar me efekt ligjor në përputhje me shtojcën 4, për sa kohë që nuk ishte marrë më parë si pjesë e procesit të parakualifikimit.

2.6 Anulimi i ftesës për ofertë

2.25 Ftesa për tender mund të anulohet nëse:

a) Nuk ka pasur konkurrim të përshtatshëm;

b) Asnjë nga ofertat për shërbime nuk ka arritur numrin minimal të pikëve;

c) Aspektet kryesore teknike apo financiare në të cilat është bazuar ftesa për ofertë kanë pësuar ndryshime të rëndësishme përpara dhënies së kontratës;

d) Kuotimet e çmimeve janë dukshëm dhe haptazi të tepruara;

2.26 Konkurrimi do të konsiderohet i pamjaftueshëm nëse shumë më pak oferta se sa pritej, duke pasur parasysh tregun e gjerë, arrijnë fazën e vlerësimit apo nëse çmimet e kuotuara janë haptazi të tepruara, apo nëse janë bërë marrëveshje për caktimin e çmimeve. Kur kuotat e çmimeve janë haptazi të tepruara, mund të bëhen negociata për çmimin me ofertuesin e renditur në vendin e parë, me kusht anulimin paraprak të procedurës së tenderit.

2.27 Nëse asnjë nga ofertat për shërbime nuk ka marrë minimumin e numrit të pikëve, procedura e parakualifikimit mund të hiqet dhe të kryhet një procedurë tjetër tenderimi ndërmjet ofertuesve fillimisht të parakualifikuar. Kjo procedurë është e përshtatshme vetëm nëse ndryshimi i kushteve apo termave të referencës mund t'u mundësojë ofertuesve të parë të dorëzojnë ofertat e përshtatshme për shërbime dhe objektivat fillestarë të ftesës për ofertë nuk vihen në dyshim si rezultat i ndryshimit.

2.28 Anulimi i ftesës për ofertë dhe procedura e mëtejshme kërkojnë miratimin e KfW-së. Klienti duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit me

shkrim se ftesa për ofertë është anuluar, pa shpjeguar arsyet. Nëse ftesa për ofertë është anuluar, kur opsionet e përcaktuara në 2.26 dhe 2.27 nuk janë të mundura, ftesa tjetër për ofertë normalisht do të publikohet në terma të ndryshëm që garantojnë konkurrencë më të madhe, si, p.sh., duke ndryshuar objektin apo kushtet e ftesës për tender.

2.7 Negocimi i kontratës

2.29 Pasi KfW-ja të ketë miratuar propozimin për dhënën e kontratës, Klienti do të negociojë me shpejtësi dhe efikasitet kontratën me ofertuesin që është i pari në listë. Nëse negociatat rezultojnë pa sukses, pasi KfW-ja të ketë dhënë miratimin, do të kërkohet të negociohet me ofertuesin e dytë në listë. Rifillimi i negociatave me ofertuesin me të cilin u prishën negociatat nuk lejohet.

2.30 Klienti do të kryejë negociatat në mënyrë të shpejtë dhe efikase dhe në përgjithësi do të përqendrohet në pikat e mëposhtme:

a) Qartësimin e punës dhe metodave që do të përdoren, kur është e nevojshme, përshtatjen e orarit të personelit;

b) Shërbimet e tjera që do të ofrohen nga Klienti dhe niveli i doganave dhe i akcizave, taksat dhe tatimet në vendin e Klientit, si dhe detyrimin kontraktues për t'i paguar ato;

c) Dispozitat kontraktuese mbi elemente të tjera të kostos që nuk janë përfshirë në vlerësimin e kuotimit të çmimeve.

2.31 Tarifat dhe çmimet për njësi për kostot dhe shërbimet që do të ofrohen në bazë të një pagese të vetme në përputhje me ftesën për ofertë, në parim nuk janë objekt i negocimit, pasi janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të kuotimit të çmimit.

2.32 Për sa kohë është rënë dakord për një pagesë të vetme, afati i pagesës do të caktohet në përputhje me shërbimet që planifikohen të jepen. Sapo të jetë paguar 70% e pagesës së kontratës, kështet e mbetura do të paguhen kundrejt dorëzimit të dokumenteve të lidhura me hapat specifikë të projektit.

2.33 Pasi të jetë dorëzuar oferta, personeli apo personeli kyç që përbëjnë pjesën integrale të ofertës nuk mund të zëvendësohen pa miratimin e Klientit dhe KfW-së. Zëvendësimi i personelit do të çojë në një rivlerësim të plotë të ofertës, nëse personeli i ofruar është më pak i kualifikuar se sa personeli fillestar.

2.34 Rezultati i negociatave të kontratës dhe draftkontrata e konsultimit kërkojnë miratimin e KfW-së.

2.8 Njoftimi i ofertuesve dhe ankesat

2.35 Pas përfundimit të negociatave kontraktuese dhe pasi KfW-ja të ketë dhënë pëlqimin, Klienti do të njoftojë të gjithë ofertuesit për vendimin e marrë. Me kërkesë të ofertuesve, Klienti mund t'i informojë mbi mangësitë kryesore të ofertave të tyre.

Asnjë detaj mbi vendimin e fituesit nuk zbulohet. Ofertuesve, të cilët nuk u përfshinë në vlerësimin e kuotimeve të çmimeve, do t'u kthehen kuotimet e tyre të çmimeve, të pahapura. Ofertuesit nuk kanë të drejtë ankimimi përtej të drejtave të parashikuara në ligjet e vendit partner.

2.36 Ankesat e ofertuesve lidhur me procedurën kontraktuese duhet të dorëzohen me shkrim te Klienti/autoriteti përgjegjës për ankesa në vendin partner dhe kopjet do t'i dërgohen KfW-së.

3. Forma të tjera prokurimi

3.1 Shmangiet nga parimi i ftesës ndërkombëtare publike për ofertë

3.01 Me miratimin paraprak të KfW-së, parimi i ftesës ndërkombëtare, publike dhe të pakufizuar për ofertë mund të hiqet në rastet e parashikuara si më poshtë. Përjashtimet e parashikuara në seksionin 3.2 (ftesa kombëtare për ofertë) dhe seksionin 3.3 (kërkesa për ofertë) janë të zbatueshme deri në një vlerë neto të kontratës 200,000 euro[10], me kusht që mos të jenë vendosur me marrëveshje kufij të tjerë me KfW-në. Ndarja e kontratave në disa pjesë, në mënyrë që të bien nën kufirin e lejuar, është e ndaluar.

3.2 Ftesa kombëtare për ofertë

3.02 Publikimi i ftesës për ofertë që kufizohet në vendin partner është i mundur nën kufirin e lartpërmendur, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Për detyrat e parashikuara, ofertuesit e kualifikuar të mjaftueshëm për një procedurë prokurimi konkurruese gjenden në tregun kombëtar; dhe

b) Duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit, ofertuesit ndërkombëtarë mund të mos kenë interes.

[10] Vlera e kontratës pa TVSH, por duke përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të kontratës dhe në rastet kur është e mundur.

Në rast të publikimit kombëtar të ftesës për ofertë, ofertuesit ndërkombëtarë nuk mund të pengohen të marrin pjesë apo të përjashtohen nga procedura. Zbatimi i ftesës për ofertë si një procedurë me një apo dy faza do të përcaktohet nga rrethanat e projektit në fjalë dhe rregulloret kombëtare. Dispozitat që rregullojnë ftesat ndërkombëtare për prokurim zbatohen në mënyrë të ndërsjellë.

3.3 Kërkesa për ofertë[11]

3.03 Nëse nuk plotësohen kushtet për një publikim kombëtar të ftesës për ofertë në përputhje me paragrafin 3.02, ofertat mund të kërkohen nga të paktën tre ofertues të kualifikuar.

3.04 Dorëzimi i ofertave u kërkohet vetëm ofertuesve të kualifikuar. Për këtë qëllim, Klienti do t'i paraqesë KfW-së një listë të ofertuesve të propozuar prej të cilëve do të kërkohet oferta, si dhe një llogaritje e kostos dhe do të shpjegojnë përshtatshmërinë e tyre për aktivitetin e parashikuar (përvojën e kaluar, burime njerëzore, financiare dhe ekspertiza lidhur me objektin e kontratës). Në përzgjedhjen e ofertuesve të propozuar do t'i jepet rëndësi kombinimit të ekuilibruar të përvojës kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën përkatëse të veprimtarisë.

3.05 Nëse përshtatshmëria e përgjithshme e të gjithë ofertuesve të propozuar është demonstruar mjaftueshëm, nuk është e nevojshme të kryhet kontrolli i hollësishëm i përshtatshmërisë së tyre gjatë marrjes së ofertave. Kur ka informacion të pamjaftueshëm, do të merret nga të gjithë ofertuesit së bashku me ofertat e kërkuara. Kur është e mundur, numri i ofertuesve të ftuar duhet të rritet, kështu që nëse ofertuesit përjashtohen për shkak të papërshtatshmërisë, do të mbeten për vlerësim një numër i mjaftueshëm ofertash.

3.06 Vlerësimi i dokumenteve të paraqitura dhe procedura e mëtejshme kontraktuese do të zbatojnë, për aq sa është e mundur, dispozitat e përcaktuara në seksionin 2, duke iu nënshtruar këtyre përjashtimeve:

a) Afati për dorëzimin e ofertave mund të shkurtohet në mënyrë të përshtatshme, por si rregull duhet të jetë jo më pak se 20 ditë kalendarike; dhe

b) Për ofertat që mund të përgatiten me pak punë, dorëzimi i ofertave me shkrim mund të hiqet me miratimin paraprak të KfW-së. Në këtë rast, ofertat do të dorëzohen në formë elektronike, si PDF, që nuk lejon ndryshimin e përmbajtjes së ruajtur. Ofertuesi rrezikon të përjashtohet, nëse skedarët nuk janë të lexueshëm.

3.4 Prokurimi i drejtpërdrejtë

3.07 Me prokurimin e drejtpërdrejtë merret vetëm një ofertë dhe kontrata jepet pa një procedurë konkurrimi. Prokurimi i drejtpërdrejtë është i mundur vetëm në përjashtime të garantuara, në veçanti:

a) Me zgjatjen e kontratave ekzistuese, në rastet kur natyra dhe qëllimi i shërbimeve konsultuese që kontraktohen nuk sigurojnë një ftesë të re për ofertë;

b) Në fazat e aktiviteteve të programit ku termat e referencës janë kryesisht identike, me kusht që kontrata e parë të jetë dhënë mbi bazë konkurrimi, në ftesën për ofertë i është kushtuar vëmendje këtij opsioni, performanca e Konsulentit është e kënaqshme dhe propozimi teknik dhe kuotimi i çmimit janë të përshtatshme;

c) Pas anulimit të ftesës për tender, në përputhje me seksionin 2.6, për aq kohë sa procedura e konkurrimit nuk mund të japë rezultate të përshtatshme;

d) Kur projektet janë veçanërisht urgjente, në raste të fatkeqësive natyrore, krizave apo konflikteve;

e) Nëse mund të konsiderohet vetëm një ofertues për zbatimin e aktiviteteve për arsye konfidencialiteti ose pasi kërkohen njohuri teknike, sistematike apo me përmbajtje sensitive;

f) Për kontrata me vlerë maksimale deri 20,000 euro (pa përfshirë TVSH-në, por duke përfshirë të gjitha elementet e tjera kontraktuese dhe mundësisht opsione), me kusht që përshtatshmëria e veçantë apo ekskluzive e Konsulentit që do të kontraktohet është demonstruar në mënyrë të besueshme nga Klienti dhe një ftesë për ofertë nuk do të sillte përfitime ekonomike.

3.08 Në rastet e prokurimit të drejtpërdrejtë, Klienti gjithmonë do të verifikojë përshtatshmërinë e propozimit teknik dhe kuotimit të çmimeve, si dhe çdo përbërës tjetër të ofertës.

[11] Nëse klient është KfW-ja, do të aplikohet pragu i BE-së, vlera në 2016: 200,900 euro.

Rezultati i kësaj procedure verifikimi duhet të dokumentohet me shkrim dhe kërkon miratimin e KfW-së përpara përfundimit të kontratës.

4 Projekte që përfshijnë ndërmjetësues financiarë dhe projekte të sektorit privat

4.1 Projekte që përfshijnë ndërmjetësues financiarë

4.01 Kur fondet dorëzohen nga ndërmjetës financiarë dhe këto fonde përdoren për të financuar disa projekte individuale, p.sh, në sektorin e infrastrukturës, zakonisht nuk është e mundur të specifikohen paraprakisht detajet e zbatimit të projekteve në fjalë. KfW-ja do të sigurojë që ndërmjetësi financiar të kërkojë nga huamarrësit të aplikojnë procedurat e prokurimit që janë në përputhje me parimet e këtyre udhëzimeve dhe kontratat të lidhen në bazë të parimeve ekonomike, të jenë transparente dhe të justifikuara. Përveç kur është rënë dakord ndryshe, ndërmjetësi financiar do të mbikëqyrë dhënien e kontratave dhe më pas do t'i raportojë KfW-së si pjesë të procedurave të zakonshme të raportimit. Dispozitat 4.02 dhe 4.03 zbatohen për huamarrës të sektorit privat, të cilët zbatojnë projekte të mëdha individuale.

4.2 Projekte të sektorit privat

4.02 Projektet e sektorit privat janë projekte të zbatuara nga Klientë që nuk ushtrojnë detyra publike, nuk janë nën kontrollin e shtetit dhe normalisht nuk janë të detyruar të kryejnë një ftesë publike për ofertë. Klientët e sektorit privat zakonisht kanë procedurat e veta të prokurimit. KfW-ja siguron paraprakisht që procedurat e prokurimit të zbatuara nga Klienti përkatës të përdorin fondet në mënyrë efikase dhe dhëniet e kontratave të jenë transparente dhe të justifikueshme.

4.03 Për disa projekte, të tilla si partneritetet publike-private (PPP), zhvillohet një konkurs në një nivel tjetër përpara prokurimit aktual, p.sh., një element i grantit minimal (subvencionet me kosto më të ulët) të përcaktuara në konkurrim apo shpërblime maksimale për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës (p.sh., çmimi i ujit). Prokurimet e bëra më pas dhe që do të financohen nga KfW-ja, mund të bëhen nën përgjegjësinë dhe sipas rregullave të Klientit nëse Klienti mund t'i tregojë paraprakisht KfW-së se vendimet mbi dhënien e kontratës bazohen në parime ekonomike, janë transparente dhe të justifikuara dhe nëse këto prokurime janë pjesë e konkurrimit.

4.04 Përfshirja e KfW-së në zbatimin e procedurave përkatëse të prokurimit të përcaktuara në 4.02 dhe 4.03 do të rregullohet në bazë të një projekti të veçantë.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1
FUSHAT E PUNËS PËR SHËRBIME KONSULENCE

Në Marrëveshjen Financiare, agjencitë e zbatimit të projektit marrin shërbime mbështetëse dhe këshilluese të Konsulentëve kryesisht në fushat e mëposhtme. Shërbimet këshilluese të cilat do të përdoren në projektin specifik do të përcaktohen nga Klienti dhe KfW-ja rast pas rasti.

a) Përgatitja

- Studimet sektoriale dhe paraprake të zhvilluara përpara marrjes së vendimit kryhen për të vazhduar me përgatitjet e një projekti. Qëllimi i studimeve të tilla është kryerja e një seleksionimi fillestar, me përpjekje të justifikueshme, nga opsionet ekzistuese dhe përcaktimi i fushës për propozime që janë të përshtatshme sipas konsideratave teknike, ekonomike, institucionale, social-ekonomike, social-kulturore dhe ekologjike.

- Studimet e fizibilitetit të përgatitura si bazë për vendimmarrjen mbi një projekt që duhet të përgatitet sipas aspekteve teknike, ekonomike, institucionale, social-ekonomike, social-kulturore dhe ekologjike.

b) Zbatimi

Mbështetje për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në hartimin e hollësishëm të projektit, si bazë për tenderin (duke përfshirë specifikimet teknike dhe draftkontratat për furnizime dhe shërbime), kryerjen e tenderit, vlerësimin e ofertave dhe propozimin e ofertuesit për lidhjen e kontratës, hartimin e kontratës, hartimin përfundimtar, duke përfshirë planet arkitekturore, mbikëqyrjen e zbatimit të projektit dhe monitorimin e zhvillimit të tij. Shërbimet e Konsulenti, gjithashtu, përfshijnë shqyrtimin dhe miratimin e faturave dhe mbështetjen e Agjencisë së Zbatimit të Projektit në koston e parashikuar dhe menaxhimin financiar të projektit, në

trajtimin e çështjeve kontraktuese, pranimin e projektit dhe hartimin e raporteve për zhvillimin e projektit.

c) Operimi

Mbështetje për Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zhvillimin e koncepteve të operimit dhe të mirëmbajtjes, në këshillim dhe trajnim të personelit të kualifikuar për të drejtuar dhe për të mirëmbajtur objektet e ndërtuara në kuadër të projektit dhe për marrjen e masave shoqëruese (si, p.sh., fushata këshilluese për higjienën lidhur me projektet e furnizimit me ujë të pijshëm).

d) Masa të tjera mbështetëse dhe këshilluese

Mbështetje për Agjencinë e Zbatimit të Projektit me këshillim mbi politikat e sektorit (si, p.sh., reforma tatimore), reformat institucionale, mbi përmirësimin e strukturave organizative dhe drejtuese dhe/ose kryerjen e kontrollove mjedisore.

SHTOJCA 2
TË DREJTAT E KfW-së PËR INFORMACION DHE MIRATIM

1. Planifikimi i procedurës kontraktuese

Klienti do t'i paraqesë për miratim KfW-së dokumentet e mëposhtëm në kohën e duhur, përpara fillimit të procedurës kontraktuese për shërbimet e konsulencës:

- përshkrimin e karakteristikave të veçanta vendore dhe deklaratën e çdo rregulloreje vendore të zbatueshme për procedurat kontraktuese;
- draftlistën e shërbimeve të kërkuara (termat e referencës);
- afatet kohore për procedurën kontraktuese;
- vlerësimi i kostos për shërbimet e konsulencës;
- kalendari i parashikuar për kryerjen e shërbimeve të konsulencës;
- draftkontrata e konsulencës, ndër të tjera, përfshin;
- specifikat vendore dhe ligjin detyrues në lidhje me zbatimin dhe kryerjen e kontratave të konsulencës[12];
- shërbimet e ofruara falas nga Klienti (p.sh., ofrimi i ambienteve të zyrës, automjeteve, pajisjeve dhe stafit);
- mundësinë dhe kushtet për përjashtimin e shërbimeve të konsulencës nga doganat dhe akcizat, taksat dhe tatimet në vendin e Klientit;
- llojin e kontratës (pagesë e vetme apo e bazuar në punën e kryer).

Klienti do të informojë menjëherë KfW-në për vonesa apo ndryshime gjatë procedurës kontraktuese që mund të rrezikojnë përfundimin me sukses të projektit, në përputhje me afatet kohore dhe do të bien dakord për hapat që duhet të merren për rregullimin e kësaj situate.

2. Zbatimi i procedurës kontraktuese

Për t'i mundësuar KfW-së ushtrimin e së drejtës për miratim, Klienti do t'i dërgojë KfW-së në kohën e duhur dokumentet e mëposhtme për shqyrtim dhe komente. Miratimi nga KfW-ja kërkohet përpara fillimit të çdo aktiviteti të mëposhtëm:

- *përpara publikimit*: drafti i njoftimit për parakualifikim (komponentët kryesorë, shihni shtojcën 3) dhe çdo informacion shtesë për Konsulentët e interesuar;
- *përpara njoftimit të ofertuesve:* Raporti i Vlerësimit mbi parakualifikimin dhe draftlista e ofertuesve të parakualifikuar, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse sipas kërkesës së KfW-së;
- *përpara dërgimit tek ofertuesit e parakualifikuar* të miratuar paraprakisht nga KfW-ja: projektdokumentet për ofertë (ftesa për dorëzimin e ofertës, termat e referencës, kushtet e tenderit dhe kushtet e kontratës për ofertuesin, për detaje shihni shtojcën 6);
- *përpara hapjes së kuotimeve të çmimeve:* Raportin e Vlerësimit mbi shërbimet e ofruara që duhet të parashikojë arsyet për çdo përjashtim dhe të gjitha dokumentet përkatëse sipas kërkesës së KfW-së;
- *përpara një anulimi të mundshëm të tenderit*: propozimi nga Klienti për anulimin e tenderit duhet të jetë i arsyetuar. Duhet të zbatohen kriteret në udhëzimet për anulim dhe duhet të dërgohet së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të kërkuara nga KfW-ja;
- *përpara fillimit të negociatave për kontratën me ofertuesin i cili doli i pari:* propozimi për dhënien e kontratës së bashku me Raportin e Vlerësimit mbi kuotimet e çmimit dhe mbi zgjedhjen përfundimtare dhe të gjitha dokumentet përkatëse të kërkuara nga KfW-ja;
- *përpara fillimit të negociatave për kontratën me ofertuesin i cili doli i dyti:* propozimi për të nisur

[12] Kur është e mundur do të përdoret kontrata tip e KfW-së.

negociata me ofertuesin, që duhet të parashikojë arsyet e dështimit të negociatave me ofertuesin e parë;

- përpara vendosjes mbi një propozim nga Konsulenti i përzgjedhur për të zëvendësuar stafin: propozimi i personelit nga Konsulenti duke përfshirë CV-të e plota, rivlerësimin e ofertës së tij dhe deklaratën e pozicionit të Klientit për këtë propozim, të arsyetuar;

- përpara nënshkrimit të kontratës së konsulencës: rezultati i negociatave mbi kontratën dhe draftkontratën, duke iu referuar çdo zëvendësimi të personelit dhe çdo ndryshimi të shërbimeve apo draftkontratës;

- përpara pagesës së parë: një kopje e nënshkruar e kontratës së konsulencës.

3. Mbikëqyrja e shërbimeve të konsulencës dhe ndryshimet në kontratën e konsulencës

Klienti është përgjegjës për mbikëqyrjen e përmbushjes së kontratës dhe pranimin e shërbimeve të konsulencës. Klienti duhet të sigurojë që Konsulenti:

- t'i dërgojë KfW-së në kohë, progresraportet dhe raportet e tjera mbi punën e kryer, në numrin e rënë dakord;

- të informojë KfW-në pa vonesë për çdo rrethanë të jashtëzakonshme që ndodh gjatë kryerjes së shërbimeve dhe mbi të gjitha çështjet të cilat kërkojnë miratimin e KfW-së;

- lejojë KfW-në dhe përfaqësuesit e saj të inspektojnë librat, të cilët mbahen nga Konsulenti dhe dokumentet mbi shërbimet e kryera dhe të bëjë kopje të tyre.

- në rast të mbikëqyrjes së punës në ndërtim, të lejojë KfW-në dhe përfaqësuesit e saj të kontrollojnë garancitë e dorëzuara nga sipërmarrësit, për të monitoruar periudhën e vlefshmërisë së tyre dhe, kur është e përshtatshme, të kërkojnë zgjatjen e tyre në kohën e duhur.

Çdo zgjatje afati, shtesë apo ndryshim i kontratës apo i përshkrimit të shërbimeve, që përmban çdo anulim i një dispozite të kontratës dhe çdo zëvendësim i personelit kyç, kërkon miratimin paraprak të KfW-së. Për këtë qëllim, Klienti informon KfW-në në kohë të arsyeshme për ndryshimet e synuara, duke paraqitur arsyet dhe paraqet një kopje të ndryshimit të kontratës.

SHTOJCA 3
ELEMENTE THELBËSORE NË NJOFTIMIN PËR PARAKUALIFIKIM

Njoftimi i parakualifikimit hartohet për të informuar firmat e konsulencës së interesuara për projektin e parashikuar të FC-së dhe shërbimet e kërkuara të konsulencës. Publikimi duhet të jetë i shkurtër dhe informues. Informata të mëtejshme do të vihen në dispozicion. Këto dokumente duhet të tregojnë, gjithashtu, koeficientin që do t'u bashkëngjitet nënkritereve të posaçme. Parakualifikimi duhet të shpallet në mediet vendore dhe ndërkombëtare, por të paktën ndërmjet agjencisë së tregtisë së jashtme dhe investimeve të brendshme të Republikës Federale të Gjermanisë, Tregtia dhe Investimi Gjermani (GTAI).

Adresa: Tregtia dhe Investimi Gjerman,
Villemombler Strasse 76,
53123 Bon,Gjermani

Telefon: +49 (228) 24933- 374 or -377,

Faks: +49 (228) 24933 - 446

Email: kfw-tender@gtai.de

- Njoftimi i parakualifikimit duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

- referenca për parakualifikim;

- emri i Klientit dhe i vendit;

- sektori/ët që do të mbështeten;

- përshkrim i shkurtër i projektit;

- përshkrim i shkurtër i shërbimeve të kërkuara të konsulencës (duke iu referuar fazave të kryerjes, nëse është e zbatueshme);

- lloji i ofertuesit të kërkuar (Konsulentë të pavarur, të kualifikuar);

- kur është e përshtatshme, masat lidhen me bashkëpunimin me Konsulentë ndërkombëtarë dhe vendorë me përvojë vendore;

- financimi për shërbimet e konsulencës (burimiet dhe gjendja e përgatitjes);

- referenca për çdo informacion në dispozicion dhe vendin ku mund të merren këto dokumente;

- detajet e aplikimit (numri i origjinalit /i kopjeve, gjuha, adresat, linjat e komunikimit);

- afati i pranimit (të paktën 30 ditë kalendarike pas publikimit të njoftimit);

- dokumentet që duhet të dorëzohen: profili dhe statusi i korporatës, dëshmi e burimeve financiare dhe ekspertiza në lidhje me masën e kontratës (*ndër të tjera* konfirmimi i garancisë së

dhënë nga banka kryesore e shoqërisë; Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë, e nënshkruar nga ofertuesi dhe e detyrueshme ligjërisht në përputhje me shtojcën 4. Kërkesa për prova të tjera varet nga qëllimi i shërbimeve që do të kryhen (p.sh., bilancet dhe llogaritë e fitimeve dhe humbjeve për tri vitet e fundit), referencat përkatëse për të dëshmuar kualifikimet teknike dhe përvojën jashtë vendit, në rajon apo në vend, detaje mbi personelin e Konsulentit që do të ofrojë shërbime monitorimi dhe mbështetje nga zyra qendrore, detajet e strukturës së personelit (numri dhe kualifikimet), deklarata e qëllimit lidhur me bashkëpunimin (emri i shoqërisë drejtuese), deklarata mbi firmat e bashkuara, nëse specifikohen dokumente të tjera që duhet të dorëzohen;

- Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë në përputhje me shtojcën 4.

SHTOJCA 4
DEKLARATA E PRANIMIT TË PËRGJEGJËSISË

Ne theksojmë rëndësinë e një procedure kontraktuese të lirë, të drejtë dhe konkurruese që përjashton praktikat abuzive. Në lidhje me këtë, ne nuk kemi ofruar dhe as nuk kemi dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë avantazhe të papranueshme ndonjë nëpunësi publik apo personi tjetër dhe as nuk kemi pranuar avantazhe të tilla në lidhje me ofertën tonë dhe as nuk ofrojmë apo japim, apo pranojmë nxitje apo kushte të tilla në këtë proces tenderimi, apo në rast se lidhet kontrata, në zbatimin e mëtejshëm të kontratës. Ne, gjithashtu, deklarojmë se nuk ekziston ndonjë konflikt interesi në kuptimin e udhëzimeve përkatëse[13].

Ne, gjithashtu, theksojmë rëndësinë e respektimit të standardeve mjedisore dhe sociale në zbatimin e projektit. Ne marrim përsipër të zbatojmë legjislacionin përkatës së punës, si dhe standardet bazë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), si dhe standardet e zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit dhe standardet e shëndetit dhe sigurisë.

Ne do të informojmë personelin mbi detyrimet e tyre përkatëse, detyrimin për përmbushjen e kësaj deklarate të sipërmarrjes dhe t'u binden ligjeve të vendit të[●] (emri i vendit).

Ne, gjithashtu, deklarojmë se shoqëria jonë/të gjithë anëtarët e konsorciumit nuk janë të përfshirë në listën e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, të BE-së apo të qeverisë gjermane dhe as në ndonjë listë tjetër sanksionesh dhe konfirmojmë se shoqëria jonë/të gjithë anëtarët e konsorciumit do të informojnë menjëherë Klientin dhe KfW-në, nëse kjo situatë ndodh në një periudhë të mëvonshme.

Ne pranojmë, se në rast se shoqëria jonë (apo një anëtar i konsorciumit) i shtohet listës së sanksioneve që janë ligjërisht të detyrueshme për Klientin dhe/apo KfW-në, Klienti ka të drejtë të na përjashtojë ne/konsorciumin apo, nëse kontrata i është dhënë shoqërisë sonë/ konsorciumit, të anulojë menjëherë atë kontratë nëse deklarimet e bëra në Deklaratën e Sipërmarrjes kanë qenë të pavërteta apo arsyeja për përjashtimin nga procedura e tenderit ndodh pas lëshimit të Deklaratës së Sipërmarrjes.

....
(Vendi) (Data) (Emri i shoqërisë)

.....
(Firma)

SHTOJCA 5
INFORMACION PËR PROCESIN E PARAKUALIFIKIMIT

1. Shënimet, shpjegimet dhe kriteret e mëposhtme për parakualifikim shërbejnë si bazë për parakualifikimin e aplikantëve të përshtatshëm në procedurën e përzgjedhjes në dy faza. Ato përdoren, gjithashtu, në një fazë ose në të ashtuquajturin proces pas kualifikimi, në të cilin aplikantët paraqesin dokumentet e tyre të parakualifikimit, propozimet teknike dhe kuotimet e çmimeve në të njëjtën kohë. Informacioni dhe të dhënat mbi kualifikimet e ofertuesve të cilët janë vlerësuar në fazën e parakualifikimit nuk mund të vlerësohen përsëri gjatë fazës së tenderimit, përveç nëse një ofertues i parakualifikuar është ndikuar nga ndryshimet e strukturës ekonomike, organizative apo të stafit që kërkojnë rishqyrtimin e kualifikimeve të tij.

[13] Shihni "Udhëzime për caktimin e Konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet partnere" dhe "Udhëzime për prokurimin e mallrave, punë dhe shërbime në bashkëpunimin financiar në vendet partnere".

2. Kërkesat lidhur me dokumentet që duhet të dorëzohen dhe qëllimi i tyre duhet të përshtaten me projektin specifik. Krahas vëllimit të punës që do të kryhet, në procedurën e parakualifikimit do të merret parasysh dhe natyra e shërbimeve që kërkohen (si p.sh., burimet financiare luajnë më pak rol në studime të shkurtra se sa në vendosjen e një ekipi me ekspertë afatgjatë). Njoftimi i parakualifikimit duhet të paraqesë peshën/rëndësinë e bashkëngjitur në referencat e projektit. Duhet të deklarohen paraprakisht numri minimal i referencave të kërkuara për t'u kualifikuar, nëse është e nevojshme të ndara në fusha të ndryshme të përvojës, si dhe numri maksimal i referencave të kërkuara për të arritur pikët e plota.

3. Kur ofertat kërkohen nga një numër i kufizuar kandidatësh të përzgjedhur më parë, shqyrtimi i përshtatshmërisë së këtyre kandidatëve mund të hiqet tërësisht ose pjesërisht, vetëm nëse ka informacion të mjaftueshëm mbi kandidatët e propozuar. Në rast të kundërt, ndiqet e njëjta procedurë si në procedurën pas kualifikimit, që vlerëson përshtatshmërinë e ofertuesve.

4. Dokumentet e aplikimit duhet të provojnë burimet financiare të aplikuesit, përvojën dhe aftësinë e përgjithshme për të kryer shërbimet e kërkuara, si dhe njohuritë sektoriale dhe rajonale. Gjithashtu, duhet të provojnë stafin e përshtatshëm. Dokumentet duhet të jenë të shkurtra dhe të kuptueshme, duke mbuluar fushat kryesore të aktivitetit të firmës/shoqërisë dhe shërbimet kryesore të kryera gjatë pesë viteve të fundit që janë relevante për projektin dhe duke përmbledhur disponueshmërinë e ekspertizës së kërkuar.

5. Nëse firmat konkurrojnë bashkërisht, aplikantët do të paraqesin një deklaratë të detyrueshme mbi drejtuesin kryesor dhe formën e bashkëpunimit (ndërmarrje e përbashkët, nënkontraktim, forma të tjera), duke përfshirë dhe ndarjen e parashikuar të punës. Në këtë fazë, nëse nuk janë parashikuar dispozita të tjera (si p.sh., kontratë paraprake), duhet të përfshihet deklarata e qëllimit. Përpara se t'i jepet kontrata një sipërmarrjeje të përbashkët, aplikantë duhet të lidhin një marrëveshje me përgjegjësi të përbashkët dhe të veçantë.

6. Nëse ofertuesi synon të përdorë nënkontraktues, do të mbajë përgjegjësi të plotë për shërbimet që ata kryejnë. Nuk lejohet ngarkimi i të gjitha aktiviteteve një apo i disa nënkontraktuesve.

7. Në procesin parakualifikues do të konsiderohen vetëm aplikantët, burimet financiare dhe ekspertiza e të cilëve janë çmuar të përshtatshme me vëllimin e punës që do të kryhet nga Klienti dhe KfW-ja. Vlerësimi i këtyre burimeve financiare do të bazohet në likuiditetin e aplikantit dhe xhiron vjetore lidhur me vlerën e parashikuar të kontratës. Aplikanti mund të provojë likuiditetin e tij, duke paraqitur konfirmim të kufirit të garancisë nga banka që nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj dhe është i përshtatshëm për projektin (në rast dyshimi, Klienti rezervon të drejtën për verifikim). Xhiroja vjetore zakonisht konfirmohet duke paraqitur bilancet e certifikuara apo llogaritë e fitimit dhe humbjes për tri vitet e fundit; për aplikantët të cilët nuk kanë detyrimin të kenë bilance, me paraqitjen e pasqyrës së të ardhurave neto. Përveç kur njoftimi për parakualifikim parashikon ndonjë shifër tjetër specifike të projektit, ofertuesi duhet të tregojë një xhiro vjetore (të llogaritur si vlerë mesatare për tri vitet e fundit) që është e barabartë me të paktën trefishin e xhiros vjetore maksimale të parashikuar nga kjo kontratë. Për ndërmarrjet e përbashkëta, përveçse kur përcaktohet ndryshe në njoftim, do të merret në konsideratë xhiroja e përbashkët vjetore e partnerëve; për xhiro nga sipërmarrjet e përbashkëta do të përfshihen vetëm pjesët e ofertuesit. Aplikantët të cilët nuk paraqesin dokumentacionin apo paraqesin dokumentacion jo të plotë, nuk do të përfshihen në parakualifikim.

8. Në rastin e vlerësimit të firmave të reja të konsulencës apo të firmave që dëshirojnë të shtojnë sektorë të rinj veprimi dhe/apo rajone në gamën e tyre të shërbimeve, do të përdoret përvoja e personelit kyç për projektin e FC-së, pasi ndryshe firmat do të ishin në dizavantazh në konkurrim me aplikantët e tjerë për shkak të mungesës së referencave.

9. Aplikantët të cilët janë pjesë e grupit të firmave dhe si të tillë paraqesin referencat e projektit apo të personelit nga sektorë të tjerë të firmës apo të shoqërive simotra, mund të njihen vetëm nëse mund të demonstrojnë në nivel të

pranueshëm se nëse fitojnë kontratën, do të kenë akses të pakufizuar në këto burime (p.sh., ndërmarrje të përbashkëta, nënkontraktues, nënkontraktime personeli). Kjo zbatohet edhe për provën e burimeve financiare. Në këtë rast, aplikanti duhet të demonstrojë se shoqëria mëmë apo shoqëria aksionare janë përgjegjëse për të duke pasur efekt ligjor (si, p.sh., garanci apo letër përgjegjësie).

Kriteret *(elementet e mëposhtme janë të dhëna të përafërta dhe do t'i përshtaten projektit specifik)*

		Pikët
1.	**Vërtetimi i përvojës**	**40**
1.1	*Përvojë në trajtimin e projekteve të ngjashme:*	*rreth 25*
1.2	*Përvojë në kushtet e ndryshme të punës në vendet në zhvillim, tranzicion apo duke u zhvilluar*	*rreth 10*
1.3	*Përvojë në rajon apo vend, mundësisht në të njëjtin sektor*	*rreth 5*
2.	**Përshtatshmëria për projektin specifik**	**60**
2.1	*Vlerësimi i ekspertizës specifike për këtë projekt në zbatimin e aktiviteteve*	*rreth 25*
2.2	*Vlerësimi i nivelit të personelit të ofertuesit në lidhje me shërbimet e kërkuara*	*rreth 20*
2.3	*Vlerësimi i personelit kyç në dispozicion të përhershëm për monitorimin dhe mbështetjen e ekipit të projektit nga zyra qendrore*	*rreth 10*
2.4	*A i plotësojnë kriteret formale dokumentet e aplikimit, a janë të plota dhe specifike për projektin?*	*rreth 5*
	TOTALI	**100**

Shënime rreth kritereve

1.1 Përvojë në trajtimin e projekteve të ngjashme

Qëllimi kryesor është vërtetimi i përvojës së Konsulentit në trajtimin e projekteve të ngjashme, të paktën gjatë 5 viteve të fundit. Aplikanti duhet të sigurojë referencat përkatëse të projektit që provojnë se ka fituar përvojë të mjaftueshme në projekte të ngjashme gjatë periudhës së caktuar. Prezantimi i referencave të projektit duhet të paraqesë qëllimin e çdo projekti (burime financiare, njerëzore), çfarë roli do të kryejë ofertuesi në projekt, si është integruar në kontratë për këtë projekt (kontraktuesi kryesor, nënkontraktuesi, partneri etj.) dhe nëse është e përshtatshme, cila pjesë e totalit ka qenë përgjegjëse për të prodhuar. Nëse kërkohet, ofertuesi duhet të specifikojë personat e kontaktit që punojnë për klientët përkatës të cilët mund të trajtojnë kërkesat lidhur me referencat e projektit.

Çdo përvojë negative me një ofertues nga projekte të tjera mund të përfshihet në vlerësim vetëm nëse ofertuesi është njoftuar me shkrim, nëse përvojat janë bindëse dhe nëse nuk i paraprijnë periudhës gjatë së cilës duhet të sigurohet përshtatshmëria.

1.2 Përvojë e kushteve të ndryshme të punës në vende në zhvillim, tranzicion apo duke u zhvilluar

Ky kriter mbulon përvojën në kushtet e punës të krahasueshme dhe të ndryshme në vende të ngjashme (gama e përvojës), me theks kryesor te kushtet e punës të krahasueshme. Deklaratat duhet t'u referohen provave të përshtatshme.

1.3 Përvojë në rajon apo vend, mundësisht në të njëjtin sektor

Termi "rajon" i referohet kryesisht vendit në të cilin ndodhet projekti, por për këtë vlerësim do të konsiderohet përvoja në vende të ngjashme fqinje apo në një rajon më të gjerë gjeografik. Njohuritë mbi sektorin (kur është e përshtatshme

mbi disa sektorë[14]) duhet të tregohen në formën e përshkrimeve të shkurtra të projektit[15], duke përfshirë një përshkrim të shërbimeve që Konsulenti ka kryer në çdo rast.

2.1 Vlerësimi i ekspertizës specifike për këtë projekt në zbatimin e aktiviteteve

Ky kriter është hartuar për të vlerësuar ekspertizën profesionale të ofertuesit për kryerjen e punëve të planifikuara, Ofertuesi duhet të tregojë se mund të japë ekspertizën e kërkuar në fushat e specializimit që nevojiten për zbatimin e aktiviteteve, pa asnjë kufizim. Ofertuesi nuk është i detyruar të caktojë një ekip, por të prezantojë ekspertizën ekzistuese dhe përvojën lidhur me kërkesat profesionale dhe fushat tematike në termat e referencës, të cilat përbëjnë pjesë të dokumenteve të para-kualifikimit. Nëse një shoqëri nuk ka njohuritë e nevojshme në të gjitha fushat e kërkuara, mund të rrisë mundësinë duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera apo personel të kualifikuar dhe të paraqesë dëshmi apo prova të njohurive të tyre teknike. Konsulenti duhet të prezantojë, në mënyrë të saktë, ekspertizën dhe përvojën, duke plotësuar me përshkrimet e projektit, kur është e mundur e plotësuar me një përshkrim të shkurtër të kualifikimeve të anëtarëve të personelit të tij[16], të cilët janë punësuar për këtë qëllim dhe mbeten në dispozicion.

2.2 Vlerësimi i nivelit të personelit të ofertuesit në lidhje me shërbimet e kërkuara

Vlerësimi përfshin nëse personeli i brendshëm i ofertuesit është ngushtësisht apo gjerësisht i bazuar në lidhje me shërbimet e kërkuara (personel total, fusha kualifikimi, lëndët, kualifikime speciale). Në varësi të shërbimeve që do të kryhen, aftësia për të trajtuar çështje të cilat dalin në mënyrë të papritur, mund të ketë një rëndësi të veçantë. Këtu, vlerësimi fokusohet në fushën e veprimit të burimeve njerëzore të specializuar të personelit të ofertuesit.

2.3 Vlerësimi i personelit kyç në dispozicion të përhershëm për monitorimin dhe mbështetjen e ekipit të projektit nga zyra qendrore

Ky kriter është për vlerësimin e kapacitetit të ofertuesit për drejtimin e projektit dhe sigurimin e cilësisë. Në këtë fazë, ofertuesit nuk i kërkohet të prezantojë ekipin për detyrën, por të provojë se firma ka personelin e kualifikuar me aftësi drejtuese, koordinuese dhe një ekip projekti që mund të kryejë drejtimin e punimeve. Nëse funksionet kyçe monitoruese dhe drejtuese nuk mbulohen nga personeli i ofertuesit, pikët do të zbriten nga vlerësimi; kjo mund të çojë në përjashtimin e ofertuesit nëse i mungojnë burimet. CV-të e detajuara nuk kërkohen për parakualifikimin. Dorëzimi i një tabele që tregon burimet njerëzore të përshtatshme për këto funksione, është i mjaftueshëm[17].

2.4 A i plotësojnë kriteret formale dokumentet e aplikimit, a janë të plota dhe specifike për projektin?

Dokumentet duhet të përpilohen dhe të paraqiten në një mënyrë që është specifike për projektin (jo si broshurë), në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Dokumentacioni shumë i gjerë dhe i pasaktë mund të kushtojë pikë.

SHTOJCA 6
KOMPONENTËT PËRBËRËS TË KËRKESËS PËR TENDERA

Kërkesa për tendera duhet t'u ofrojë firmave të parakualifikuara të konsulencës informacion të detajuar në projektin e parashikuar dhe shërbimet e kërkuara të konsulencës. Doku-mentet duhet të jenë informuese dhe duhet të ofrojnë të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin efikas të ofertave për shërbime dhe kuotat e çmimit. Kjo përfshin fiksimin e detajeve të vlerësimit të ofertave.

Kërkesa për tendera përfshin dokumentet e mëposhtme, në gjuhën e zakonshme, në transaksionet ndërkombëtare[18]:

[14] Nëse shërbimet mbulojnë sektorë të ndryshëm, përshkrimet e projektit do të grupohen sipas sektorit; nëse një projekt referues renditet disa herë në sektorë të ndryshëm, duhet të jepen vetëm shërbimet lidhur me sektorin në fjalë dhe të kryera nga firma. Si dëshmi për çdo sektor do të jepen jo më shumë se dhjetë raste.

[15] Faqja e projektit duhet të jetë e shkurtër. Duhet të japë informacionin e mëposhtëm: firma (personeli, si dhe në rastin e firmave të reja), vendi, emri i projektit, klienti, Agjencia e Zbatimit të Projektit, financimi, përmbledhje e shkurtër e projektit, shërbimet e kryera nga firma, përshkrim i shkurtër i shërbimit/ve, shtrirja e shërbimeve (numri i muajve të ekspertëve dhe pagesa).

[16] Personeli i pavarur që nuk ka një pozitë të përhershme punësimi me konsulentin, por ka punuar me të për shumë vite mund të llogaritet si personel i përhershëm, nëse kjo mund të dëshmohet në mënyrë të qartë.

[17] Informacion i shkurtër që përmban: emrin, kualifikimin profesional, vitet e përvojës profesionale, vitet që punon me firmën, pozicionin në firmë, fushën teknike dhe atë të specializimit, gjuhët, përvojën jashtë vendit.

[18] Nëse legjislacioni i vendit parashikon botimin në një gjuhë kombëtare, që zakonisht nuk përdoret në nivel ndërkombëtar, dokumentet duhet të përgatiten në dy gjuhë (gjuhën

1. Ftesë për ofertë;

2. Kushtet e tenderit dhe kushtet e kontratës (nëse nuk përfshihet projektkontrata e konsulencës, i gjithë informacioni që është i rëndësishëm për përgatitjen e ofertës dhe që ndikon te kostot duhet të renditet veçmas);

3. Termat e referencës.

Formatet[19] mund të parashikohen, gjithashtu, për prezantimin e ofertës për shërbime dhe kuotimin e çmimit. Nëse nuk parashikohet asnjë format, prezantimi i ofertës për shërbimet dhe kuotimi i çmimit duhet të ndjekin prezantimin lidhur me termat e referencës dhe informacionin për ofertuesit.

Komponentët përbërës të kushteve të tenderit dhe kushteve të kontratës renditen shkurtimisht më poshtë. Kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse. Dokumentet e tenderit duhet të përshtaten, të detajohen më shumë dhe kur është e mundur të plotësohen në përputhje me kërkesat e projektit.

1. Elementet e përgjithshme

- emri i Klientit dhe i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, nëse janë të ndryshëm;
- procedura me dy zarfe: oferta për shërbimet dhe kuotat e çmimit të dërgohen veçmas, në dy zarfe të vulosura;
- gjuha e hartimit të ofertës;
- vizitë informimi në terren (me rrezikun dhe shpenzimet e veta të ofertuesit);
- kërkesat lejohen vetëm me shkrim, përgjigjet do t'u dërgohen të gjithë ofertuesve, njëkohësisht dhe në kohën e duhur, por jo më vonë se katërmbëdhjetë ditë kalendarike brenda afatit të dorëzimit;
- ofertuesit e parakualifikuar mund të krijojnë ndërmarrje të përbashkëta vetëm me miratimin e Klientit dhe KfW-së, me kusht që ato të mos pengojnë konkurrencën;
- duhet arsyetuar çdo ndryshim në përbërjen e ndërmarrjeve të përbashkëta të parakualifikuara ose shkrirjen e tyre dhe këto duhet të miratohen, në të kundërt ofertuesit do të përjashtohen nga procedura e kontraktimit;
- emrat e Konsulentëve të parazgjedhur.

2. Dorëzimi i ofertave:

- ofertat i dorëzohen Klientit dhe KfW-së;
- data dhe ora e dorëzimit (në zonën UTC/GMT); ofertuesit duhet të kenë në dispozicion të paktën 45 ditë kohë për të bërë ofertat e tyre dhe më shumë ditë nëse puna është komplekse;
- ofertat i dorëzohen Klientit dhe KfW-së;
- vendi ku duhet kryer dorëzimi sipas afatit është ……;
- adresa e Klientit/organit që bën ftesën për tendera për marrjen e ofertave, në një kopje origjinale dhe në një numër specifik kopjesh;
- adresa e KfW-së, numër specifik kopjesh;
- takim publik për dorëzimin;
- afati detyrues për ofertat për shërbime dhe kuotat e çmimit; pa obligacionet e performancës /përmbushjes.

3. Përmbajtja e ofertës për shërbime:

- analiza kritike e termave të referencës;
- koncepti dhe metodat;
- organizimi dhe logjistika;
- orari dhe programimi i personelit;
- përbërja dhe CV-të e ekipit të projektit, duke përfshirë personelin mbështetës dhe kontratat me pagesë të vetme vetëm për personelin kyç;
- shpjegim i detyrës së secilit anëtar të ekipit;
- raport për shërbimet mbështetëse të parashikuara nga zyra qendrore;
- shërbimet që do të ofrohen nga nën-kontraktueset;
- deklarata e firmave/shoqërive partnere;
- deklarata e shërbimeve ose furnizimeve të tjera të ofruara nga Klienti (p.sh., ambientet e zyrës, transporti, pajisjet etj.);
- kur është ndjekur procedura e parakualifikimit, as referencat dhe as Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë (shihni shtojcën 4) nuk duhen ridorëzuar.

4. Përmbajtja për kuotimin e çmimit:

- struktura e kuotimit të çmimit (kur është e përshtatshme, formati i parashikuar);
- valuta që do të përdoret (kostot e këmbimit valutor për valutën e huaj, kostot vendore në valutën kombëtare);

ndërkombëtare, gjuhën e vendit), të cilat preferohen të vendosen në dy kolona pranë njëra-tjetrës. Në ftesat kombëtare për ofertë kjo mund të mos merret në konsideratë, me kushtin se dokumentet kryesore i paraqiten KfW-së në një gjuhë që përdoret në nivel ndërkombëtar. Kostot e përkthimit i paguan klienti.

[19] Për shembull, formate për referenca, për komente nga ofertuesi për termat e referencës dhe shërbime homologe të ofruara nga klienti, për planifikimin e stafit dhe programin e punës, për CV-të e stafit kyç dhe për strukturimin e kuotimit të çmimit.

- tarifat (të paraqitura veçmas sipas përqindjeve mujore të personelit të ekspertëve[20], pagesa në valutë të huaj, kostot për jetesën dhe akomodimin në vendin e ofrimit të shërbimit);
- kostot e transportit ndërmjet vendit të origjinës dhe vendit të ofrimit të shërbimit;
- kostot e transportit vendor;
- kostot e zyrës në vendin e ofrimit të shërbimit;
- blerje;
- hartimi i raporteve;
- kostot e tjera (në përgjithësi këto mund të jenë vetëm kosto për nënkontraktimin, qiramarrja e pajisjeve, testet laboratorike, shpime etj.); çdo kosto duhet arsyetuar.

5. Mënyrat e pagesës

- lloji i kontratës (shpërblimi me pagesë të vetme ose bazuar në punën e kryer);
- valuta;
- çmime fikse/të shkallëzuara; kur është e përshtatshme, deklarata e formulës për shkallëzimin e çmimit (ndryshime në çmim vetëm bazuar në statistika zyrtare);
- marrëveshje për pagesën e tarifave dhe të taksave doganore dhe akcizës; duhet deklaruar nëse Konsulenti përjashtohet nga taksat, tarifat doganore dhe akciza, pagesat dhe detyrimet në vendin e Klientit (kur është e përshtatshme, nuk mund të jepet deklaratë për taksat dhe detyrimet nga përjashtimi) ose garanci se këto shpenzime do të rimbursohen nga Klienti;
- mënyra e pagesës; obligacione të parapaguara (shihni shtesën 1 te shtojca 8); kur është e përshtatshme, obligacione mirëmbajtjeje (shihni shtesën 2 te shtojca 8), kriteret për disbursimin e pagesave të ndërmjetme/ përfundimtare;
- nëse Konsulenti kërkon një mënyrë tjetër pagese, ai duhet ta arsyetojë këtë.

6. Organizimi i kryerjes së shërbimeve:

- kohëzgjatja totale e pritshme; data e pritshme e fillimit të punës; kur është e përshtatshme, ndarje në faza;
- caktimi i personit të kontaktit në organizatën e Klientit;
- nëse është e zbatueshme, rekomandim/ kërkesë për bashkëpunim me Konsulentin/ ekspertët me përvojë vendëse;
- vendi ku do të kryhet puna; vendi i shërbimit/ zyra qendrore;
- kërkesa për prezantimin e logjistikës së parashikuar të Konsulentit për këtë punë.

7. Deklarata shtrënguese për shërbimet që do të ofrohen nga Klienti:

- klienti do t'i ofrojë Konsulentit të gjithë informacionin, hartat, fotografitë ajrore që ai ka në zotërim, pa pagesë, për kohëzgjatjen e autorizimit;
- klienti do të sigurojë se Konsulenti i ka të gjitha lejet e nevojshme për të marrë dokumente të tjera, harta dhe fotografi ajrore;
- klienti do ta mbështesë Konsulentin në marrjen e të gjitha lejeve të nevojshme të punës, lejet rezidenciale dhe licencat për import;
- klienti do të ofrojë disa shërbime pa pagesë, p.sh., ambientet e zyrës dhe pajisjet (mobilie, kondicioner, energji elektrike, ujë, telefon, pastrim, siguri etj.), personel të kualifikuar (lloji, numri, kualifikimet, në varësi ose të caktuar, kohëzgjatja), asistentë, shërbime të tjera mbështetëse;
- klienti do të paguajë taksat, tarifat doganore dhe akcizën dhe detyrime të tjera që lindin nga zbatimi i projektit në vendin e shërbimit.

8. Vlerësimi i ofertave për shërbime dhe kuotimi i çmimit:

- kriteret për oferta për shërbime: deklarata në përputhje me shtojcën 5 të këtyre udhëzimeve (dhe çdo nënkriter të rënë dakord) me një sistem vlerësimi fiks pikësh dhe koeficientësh;
- deklarata nëse tarifat doganore dhe akciza, taksat dhe detyrimet në vendin e Klientit duhet të përfshihen në krahasimin e çmimit (zakonisht vlerësimi nuk përfshin taksat ose detyrimet);
- cilësia minimale e ofertave për shërbimet që do të merren në konsideratë në vlerësimin e kuotave të çmimit dhe në vlerësimin e përgjithshëm (të jepen pikët minimale të 75% të pikëve);

[20] Për shembull, shpenzimet për një anëtar të personelit të kualifikuar në zyrën qendrore: paga bazë, sigurimet shoqërore, kostot e përgjithshme, administrimi i stafit, pushimet dhe leja shëndetësore, shërbimet e zyrës, kostot e komunikimeve për komisionin, shërbimet mbështetëse dhe monitorimi, përpunimi i të dhënave, siguracionet e ofruara nga firma, fitimi dhe humbjet. Kjo mbulon detyrat e përgjithshme të mbështetjes dhe monitorimit, të kryera nga stafi menaxherial në zyrën qendrore. Shërbimet e stafit menaxherial ose të punonjësve të tjerë nga zyra qendrore mund të ngarkohen veçmas vetëm nëse ata kryejnë detyra që dallojnë nga fusha lëndore dhe në kohë nga lista e rën e shërbimeve individuale.

- koeficienti i ofertës për shërbimet (zakonisht 70%) dhe koeficienti i kuotimit të çmimit (zakonisht 30%) në vlerësimin total;

- merrni në konsideratë se bisedimet për kontratën shërbejnë vetëm për qartësimin e zërave të paqartë.

9. Raportet

- raporte nga Konsulenti (lloji i raportit, përmbajtja, shpeshtësia e raportimit, marrësi, numri i kopjeve), duke përfshirë raportin përfundimtar që mbulon periudhën kontraktuese pas përfundimit të autorizimit;

- përmbajtja dhe ndarja e parashikuar (seksioni kryesor), shtojca/t, lloji dhe madhësia e çdo përmbledhjeje të krijuar);

- formati i parashikuar i raporteve (nga të dyja anët, numri maksimal i faqeve të kërkuara).

SHTOJCA 7
KOMENTE PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

1. Oferta për shërbimet duhet të paraqesë termat e referencës dhe objektivi i tyre duhet të jetë kuptuar plotësisht, si dhe metodat dhe burimet e propozuara duhet të jenë të përshtatshme dhe të përdoren si duhet për të përmbushur detyrat e kërkuara. Gjatë hartimit të ofertës për shërbimet, ofertuesit duhet të studiojnë termat e referencës, çdo kusht të veçantë në kërkesën për tendera dhe kriteret e mëposhtme të vlerësimit.

2. Gjatë vlerësimit të ofertave për shërbime, duhet t'i jepet vlerë shkurtësisë/përmbledhjes dhe saktësisë së deklaratave të ofertuesit. Meqë vlerësimi kryhet nga profesionistët, ofertuesit duhet të shmangin shpjegimet shabllon. Dokumentet duhet të jenë të plota, të qarta dhe të rregulluara në mënyrë të kuptueshme. Veçanërisht, në rastin e termave më kompleksë të referencës, prezantimi duhet të përfshijë diagrame, tabela dhe grafikë.

3. Vetëm ofertuesit që marrin jo më pak se numrin minimal të pikëve të përcaktuara në kërkesën për tendera, do t'i nënshtrohen vlerësimit të kuotave të çmimit.

4. Koeficienti i kritereve do të vendoset në kërkesën për tendera, në përputhje me kërkesat e projektit. Koeficienti për "konceptin dhe metodat" do të jetë përgjithësisht 55%–60% në fazën e studimit dhe 40%–45% për mbikëqyrjen e ndërtimit. Koeficienti për "analizën kritike të objektivit të projektit dhe termave të referencës" mund të reduktohet deri në 50% për termat e referencës që përfshijnë pak ose aspak analizë kritike të termave të referencës (p.sh., mbikëqyrja e ndërtimit). Në rastin kur Klienti dhe KfW-ja kanë rënë dakord për nënkriteret, këto dhe koeficienti i tyre do të paraqiten në kërkesën për tendera.

5. Vlerësimi i ofertave për shërbimet do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

	Kriteret	Pikët
1.	**Koncepti dhe metodat**	**40–60**
1.1	Qartësia dhe plotësia e ofertës	rreth 10 pikë
1.2	Analizë kritike e objektivit të projektit dhe termave të referencës	rreth 30 pikë
1.3	Koncepti dhe metoda e propozuar, duke përfshirë programin e punës, programimin e personelit dhe mekanizmat e monitorimit dhe koordinimit	rreth 60 pikë
2.	**Kualifikimet e personelit të caktuar përfundimisht**	**60–40**
2.1	Kualifikimet e personelit kyç që do të punësohet në projekt, veçanërisht menaxheri i projektit	rreth 90 pikë
2.2	Kualifikimet e personelit në zyrën qendrore që do të kontrollojnë dhe do të monitorojnë ekipin dhe do të ofrojnë shërbime mbështetëse	rreth 10 pikë
	TOTALI	**100**

Shënime për kriteret

1.1 Qartësia dhe plotësia e ofertës

Oferta për shërbimet duhet të marrë plotësisht në konsideratë, në formë dhe përmbajtje, termat e referencës dhe kushtet e ofertës për shërbimet në kërkesën për tendera. Duhet të paraqiten të gjithë komponentët e kërkuar të ofertës për shërbime. Qartësia e ofertës nënkupton strukturë të qartë, deklarata me shkrim të mbështetura me tabela dhe lista të përshtatshme dhe mjete të tjera botimi në përputhje me kompleksitetin e termave të referencës dhe përdorim të ekuilibruar të shtojcave që teksti kryesor të jetë i qartë dhe i saktë. Nëse ka mungesa të vogla në lidhje me termat e referencës, pikët do të zbriten. Mungesat që e kufizojnë shumë krahasimin me ofertat e tjera sjellin përjashtimin e ofertuesit.

1.2 Analiza kritike e objektivit të projektit dhe termave të referencës

Oferta për shërbime duhet të tregojë se Konsulenti e ka marrë projektin në konsideratë në mënyrë objektive dhe i ka shqyrtuar termat e tij të referencës në mënyrë kritike dhe hollësisht. Duhet shprehur çdo dyshim për përshtatshmërinë, lidhjen logjike dhe fizibilitetin e aspekteve të veçanta dhe konceptin në tërësi. Seksioni i metodologjisë duhet t'i marrë në konsideratë në mënyrë konstruktive, duke shmangur kufizimet e papranueshme.

1.3 Koncepti dhe metoda e propozuar, duke përfshirë programin e punës, planin për marrjen e personelit dhe mekanizmat e monitorimit dhe të koordinimit

Oferta për shërbime duhet të paraqesë qasjen metodologjike dhe programin e punës në atë mënyrë që të vlerësohet përshtatshmëria e tyre në lidhje me termat e referencës dhe ato të mund të krahasohen me ofertat e tjera të kualifikuara. Kjo përfshin një deklaratë për organizimin e planifikuar të punës dhe logjistikën. Nëse, në gjykimin profesional të vlerësuesve dhe KfW-së, ka mospërputhje të qarta dhe të mëdha ndërmjet termave të referencës dhe sasive të përcaktuara, oferta nuk do të merret në shqyrtim. Teksti duhet të përcaktojë qartë se si do të zgjidhet detyra dhe se si do të përdoren burimet, si do të ndahet puna ndërmjet anëtarëve të ekipit, si do të organizohet koordinimi me personat e përfshirë dhe ata të prekur dhe se si do të sigurohet cilësia e punës. Ai duhet shoqëruar me diagram, tabela dhe në rastin e punës komplekse, edhe me grafikët e duhur[21].

2.1 Kualifikimet e personelit kyç që do të punësohet në projekt, veçanërisht menaxheri i projektit

CV-ja e personelit të ekspertëve për kontratat me pagesë të vetme të personelit kyç duhet të ketë një faqe të parë që përmban një përmbledhje[22] dhe përfshin, këtu ose në tekst, një deklaratë të shkurtër nga ofertuesi për përshtatshmërinë e tyre për punën dhe funksionin e parashikuar sipas këtij projekti të veçantë (me më shumë detaje për ekspertët vendorë). Për kontratat me pagesë të vetme, ofertuesi duhet të deklarojë, gjithashtu, përbërjen e ekipit të plotë të projektit, pa renditur asnjë emër dhe periudhat e planifikuara për detyrat e ekspertëve. Këto kualifikime personale nuk do të vlerësohen në terma absolutë, por në lidhje me detyrat që do të kryhen, në përputhje me funksionet dhe fushat teknike të kërkuara dhe duke krahasuar përvojën dhe profilin e kërkesave. Vlerësimi i kritereve formale (trajnim, përvojë profesionale, përvojë rajonale, aftësi gjuhësore, përvojë në menaxhim dhe trajnim) do të ndryshojë në varësi të termave të referencës dhe funksionit.

Vlerësuesit do të shqyrtojnë, gjithashtu, nëse të gjitha fushat e nevojshme teknike dhe funksionale mbulohen në përputhje me kërkesat e projektit.

[21] Të paktën, si në vijim:
- përmbledhje e programit të planifikuar (grafik me kolona: faza pune të ndërvarura, persona që merren me secilën fazë, afate për mbledhjet, vendimet dhe dorëzimin e raporteve etj.;
- programim i personelit (grafik me kolona: koha dhe vendi i detyrës për secilin profesionist, detyrë ose veprimtari në vazhdim/me ndërprerje; duke përfshirë një tabelë që përcakton periudhat e sakta të detyrës për secilin ekspert, sipas vendit të detyrës);
- përmbledhje e sasive për të gjithë zërat e mbetur që prekin kostot (shërbimet, prokurimet, nënkontratat, qiraja, p.sh., personeli ndihmës, mjetet, udhëtimet, zyrat, pajisjet, studimet shtesë) reflektohen në kuotimin e çmimit.

[22] CV-ja duhet të përditësohet dhe të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i ofertuesit. Faqja e parë (një faqe) duhet të përmbajë emrin e firmës/shoqërisë, emrin e personit, kualifikimet profesionale dhe vitin e marrjes së këtyre kualifikimeve, specializim teknik dhe përvojë, llojin e përvojës (p.sh., studime, zbatim projektesh, industri, kërkim, administrim etj.), përvojën menaxheriale (p.sh., lider ekipi, menaxher departamenti, menaxher biznesi etj.), përvojën rajonale (vendi, lloji i veprimtarisë, kohëzgjatja), gjuhën amtare, gjuhët e huaja, marrëdhënien me ofertuesin (që prej ...), grafik për punën profesionale dhe punëdhënësit (koha, punëdhënësi, veprimtaria, vendi i shërbimit), komente.

Rëndësi e veçantë do t'u kushtohet edhe kualifikimeve të menaxherit të projektit, pasi ai ka përgjegjësi operacionale për kryerjen e shërbimeve. Në rastin e tij, përvoja menaxheriale, aftësitë gjuhësore, njohuritë për metodat e planifikimit dhe përvoja e kufizuar do të jenë përgjithësisht më të rëndësishme se sa në rastin e punonjësve të tjerë të kualifikuar.

2.2 Kualifikimet e personelit në zyrën qendrore që do të kontrollojnë dhe do të monitorojnë ekipin dhe do të ofrojnë shërbime mbështetëse.

Konsulenti duhet të tregojë se ai (vetëm ose në bashkëpunim me firma/shoqëri të tjera) mund të ofrojë shërbime mbështetëse kompetente për ekipin që punon në nivel vendor për të gjitha çështjet teknike që mund të lindin, duke përdorur personelin e brendshëm me përvojë dhe që mund të kontrollojë dhe të monitorojë punën. Ekspertiza e përgjithshme profesionale dhe përvoja menaxheriale janë më të rëndësishme në këtë rast se sa njohuritë gjuhësore ose për rajonin. Në rastin e shërbimit afatgjatë dhe studimeve të detajuara, mbështetja nga zyra qendrore do të jetë më e rëndësishme se sa në rastin e studimeve të shkurtra, pasi menaxherit të projektit do t'i kalojnë më shumë përgjegjësi.

SHTOJCA 8
KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS/KOMPONENTËT KRYESORË TË KONTRATËS SË SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

1. Kontrata

Kur është e mundur, duhet të përdoret kontrata tip e hartuar nga KfW-ja. Nëse jo, kontrata duhet të formulohet mbi bazën e praktikave të pranuara në nivel ndërkombëtar. Duhet të përfshihen minimalisht përcaktimet e mëposhtme kontraktuese.

2. Shërbimet që do të ofrohen nga Konsulenti

2. 1 Përshkrimi

Me nënshkrimin e kontratës së konsulencës, Konsulenti merr përsipër të përmbushë detyrën që i është caktuar. Shërbimet e detajuara të rëna dakord për këtë qëllim dhe metodat e punës që do të përdoren rezultojnë nga termat e referencës, të mbështetura nga oferta për shërbime që dorëzohet nga Konsulenti. Kjo ofertë e detajuar e shërbimeve, ku bazohet vendimi për dhënien e kontratës, është pjesë kryesore e kontratës së konsulencës, me shtesa dhe ndryshime që rezultojnë nga bisedimet për kontratën.

Në përgjithësi, përshkrimi i shërbimeve do të përfshijë:

- një deklaratë për objektivin e detyrës së konsulencës dhe termat e referencës që rezultojnë për Konsulentin;
- një listë të detajuar të shërbimeve individuale minimale të nevojshme për arritjen e këtij objektivi;
- një listë të dokumenteve (studime, raporte, plane) që do të paraqitet nga Konsulenti për të treguar progresin dhe rezultatet e punës së tij. Qëllimi, shpeshtësia dhe kërkesat e cilësisë për raportet duhet të përcaktohen me detaje dhe duhet të jenë detyruese. Për vonesa ose mangësi në raporte mund të vendosen gjoba deri në shuma të mëdha.

2.2 Grafiku kohor

Grafiku kohor duhet të dokumentojë rendin kronologjik, sipas së cilit do të kryhen shërbimet dhe përmbajtjen e tyre, si dhe do të jetë detyrues. Ai duhet të paraqesë, gjithashtu, ngjarjet kryesore të projektit ("fazat më të rëndësishme") që lidhen me shërbimet e konsulencës. Për vonesa, mund të vendosen gjoba deri në shuma të mëdha.

2.3 Plani për pajisjen me personel

Plani për pajisjen me personel rregullon numrin dhe kualifikimet specifike të projektit për personelin që do të punësohet në fusha të ndryshme të shërbimit dhe kohëzgjatjen e shërbimit të tyre dhe i cakton qartë në planin e veprimtarive. Ai duhet të dokumentojë, gjithashtu, bashkëpunimin me personelin e Klientit të caktuar për projektin.

3. Shërbimet që do të ofrohen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit (si Klient)[23]

3.1 Detyrimi për ofrimin e informacionit

Klienti do ta pajisë Konsulentin, për kohëzgjatjen e shërbimit dhe pa pagesë, me të gjitha të dhënat, dokumentet dhe informacionin ku ai ka akses dhe që janë të nevojshme për zbatimin e kontratës së konsulencës.

3.2 Shërbimet homologe

Klienti merr përsipër t'i ofrojë Konsulentit, në kohën e duhur dhe plotësisht, të gjitha shërbimet

[23] Në rastin kur Agjencia e Zbatimit nuk është Klienti, parimet më poshtë zbatohen njëlloj për klientin aktual.

e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij dhe që janë të detajuara në dokumentet e tenderit.

3.3 Detyrimi i përgjithshëm për ofrimin e mbështetjes

Klienti merr përsipër të marrë në kohë lejet zyrtare të nevojshme nga Konsulenti për punën e tij (vizat, lejet e punës etj.).

4. Pagesa

Pagesa e Konsulentit (tarifa dhe shpenzime të tjera rastësore) do të bihet dakord mbi bazën e kuotimit të tij të detajuar të çmimit, kur është e përshtatshme të ndryshohen gjatë bisedimeve për kontratën. Pagesa do të bëhet veçmas për komponentët e valutës vendëse dhe të huaj. Tarifa llogaritet për kontributin e personelit të propozuar në ofertë dhe është e përshtatshme për shërbimet e rëna dakord, në norma mujore të ekspertit për kualifikimet e kërkuara. Pagesa do të bëhet, gjithashtu, për shpenzimet e nevojshme për materialet dhe kostot e udhëtimit dhe shpenzime të tjera rastësore. Këto kosto duhen paguar në një pagesë të vetme. Në kontratë deklarohet nëse pagesa për shërbimet do të kryhet si pagesë e vetme kundrejt shërbimeve të kryera apo në këste për arritjen e objektivave të rënë dakord. Në rastin e studimeve do të preferohet pagesa e vetme. Zakonisht, KfW-ja nuk pranon një marrëveshje për tarifat, si përqindje e kostove të projektit.

5. Kushtet e pagesës

Klienti është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe si rrjedhojë edhe për kryerjen e pagesave sipas kontratës së konsulencës. Në veçanti, Klienti është përgjegjës për të garantuar se të gjitha pagesat janë kryer pa vonesë dhe në përputhje me përcaktimet kontraktuese. Nëse pagesat nuk merren në kohën e duhur për arsye për të cilat përgjegjës është Klienti, Konsulenti mund të kërkojë rimbursim të kostove të shkaktuara nga vonesa.

Konsulenti nuk ka të drejtë rekursi dhe, në veçanti, as pretendime për pagesë ndaj KfW-së sipas marrëveshjes së huas ose të financimit të nënshkruar për projektin. KfW-ja kryen pagesën sipas marrëveshjes së huas ose të financimit, me kërkesë të personit të autorizuar sipas kësaj kontrate.

5.1 Pagesa paraprake

Pagesa paraprake është një shërbim paraprak nga Klienti për të mbuluar kostot e mobilizimit të Konsulentit. Ajo kryhet kur nënshkruhet kontrata ose menjëherë pas saj, me dorëzimin e një fature. Si rregull, ajo nuk duhet ta tejkalojë masën 15% të vlerës totale të kontratës ose 150,000 euro apo ekuivalentin e saj në valutë tjetër. Ofrimi i një garancie të pagesës paraprake [garanci tip për pagesën paraprake] kërkohet nëse pagesa paraprake tejkalon 15% të vlerës së porosisë dhe në rast se e tejkalon shifrën 150,000 euro (apo ekuivalentin e saj në valutë tjetër).[24]

5.2 Pagesat e ndërmjetme

Pagesat e tjera (kështet) do të kryhen në përputhje me progresin e pritshëm të shërbimeve me jo më pak se një pagesë në çdo tremujor me dorëzimin e një fature. Pas disbursimit në masën 70% të pagesës së kontratës, çdo pagesë tjetër e ndërmjetme do të kryhet vetëm për dokumentet që lidhen me fazat specifike të rëndësishme të projektit (p.sh., raportet e progresit).

Nëse, sipas marrëveshjes, një pjesë e pagesës varet nga rezultatet ose suksesi, kjo pjesë e saj duhet të faturohet veçmas. Pagesat do të kryhen vetëm për të dhëna të rëna dakord të rezultateve ose të suksesit.

5.3 Pagesat përfundimtare

Pagesa përfundimtare do të kryhet pas përfundimit të shërbimeve dhe pranimit të tyre nga Klienti dhe KfW-ja. Kjo do të jetë të paktën 5% e pagesës së kontraktuar (p.sh., projektimi përfundimtar dhe mbikëqyrja e ndërtimit). Në rastin e studimeve, ajo është zakonisht 10% (për kontratat e punës 20%) e pagesës së kontraktuar. Në rastin e projektimit përfundimtar dhe të mbikëqyrjes së ndërtimit, pagesa për pranimin përfundimtar mund të disbursohet me pranimin e përkohshëm kundrejt një garancie bankare për shumën e përshtatshme që është e vlefshme deri në datën e pranimit përfundimtar. Kjo garanci duhet t'i shlyhet KfW-së [25].

5.4 Klauzola e përshkallëzimit të çmimit

Kontratat më shumë se njëvjeçare mund të përfshijnë një klauzolë përshkallëzimi të çmimit. Ajo duhet të orientohet përgjithësisht drejt pagës zyrtare dhe nivelit të çmimit në vendin e Konsulentit (kostot e këmbimit të valutës së huaj) ose në vendin e Klientit (kostot e valutës vendëse). Kontrata mund të përcaktojë formulën

[24] Në shtesën 1 paraqitet një model marrëveshjeje për obligacionet e parapaguara.

[25] Në shtesën 2 paraqitet një model garancie për obligacionet e mirëmbajtjes.

e shkallëzimit të çmimit dhe bazën për llogaritje në formularin e treguesve, bazuar në statistika zyrtare.

6 Procedura e disbursimit

Për disbursimin mund të bihet dakord për një nga dy procedurat e mëposhtme:

- klienti mund t'i ketë paguar shumat e faturuara nga Konsulenti drejtpërdrejt te Konsulenti nëpërmjet KfW-së në datën e caktuar (metoda e drejtpërdrejtë e pagesës);
- klienti mund të kryejë pagesa për shërbimet e paraqitura të konsulencës dhe mund të rimbursohet nga KfW-ja (procedura e rimbursimit).

7. Dispozita të tjera

7.1 Pavarësia e Konsulentit

Konsulenti dhe firmat/shoqëritë me të cilat lidhet ai, marrin përsipër të mos aplikojnë si prodhues, furnizues apo firma ndërtimi në të njëjtin projekt ku ata veprojnë si Konsulentë. Shkelja e kësaj dispozite mund të rezultojë në zgjidhjen përfundimtare të kontratës së konsulencës dhe rimbursimin e të gjitha shpenzimeve të shkaktuara nga Klienti në atë datë dhe të të gjitha humbjeve dhe dëmeve të shkaktuara nga Klienti nëpërmjet zgjidhjes së kontratës.

7.2 Përgjegjësitë

Konsulenti angazhohet para Klientit të kryejë shërbimet e rëna dakord, të plota, në përputhje me kalendarin e rënë dakord dhe në përputhje me standardet e njohura profesionale. Brenda kësaj fushe veprimi ai është përgjegjës për çdo shkelje të kontratës që i atribuohet atij.

Në rastet e neglizhencës së vogël, përgjegjësia e Konsulentit kufizohet në vlerën e kontratës ose në shumën përkatëse të shkaktuar, cilado qoftë më e madhe. Përgjegjësia për neglizhencën e qëllimshme dhe të madhe nuk preket nga kjo.

Përgjegjësia përfundon kur shërbimet e rëna dakord në kontratë pranohen nga Klienti ose me skadimin e periudhës së garancisë. Zakonisht, përjashtohet detyrimi për dëmet pasuese.

7.3 Forca madhore

Forca madhore nënkupton ngjarje të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve të kontratës dhe që pengojnë njërën prej tyre ose të dyja që të zbatojnë kontratën. Ato përshijnë kriza, të cilat bëjnë që Konsulenti të tërheqë personelin e tij, me kërkesën e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë. Përjashtohet përgjegjësia për dëmet gjatë mungesës së Konsulentit të shkaktuara nga forca madhore. Për aq kohë sa një rast i tillë vazhdon, pala e cenuar do të lirohet nga detyrimet e saj sipas kontratës. Në parim, Konsulenti ka një pretendim për vijimin e duhur të kontratës dhe, në përgjithësi, rimbursimin e humbjeve dhe dëmeve që ai pëson. Nëse forca madhore vazhdon pa ndërprerje për një periudhë më të gjatë (p.sh., 180 ditë kalendarike), secila prej palëve mund ta zgjidhë kontratën.

7.4 Zgjidhja e kontratës

Si rregull, Klienti mund ta zgjidhë kontratën e konsulencës në çdo kohë, duke bërë një njoftim të paktën 30 ditë kalendarike para zgjidhjes së saj, me miratimin paraprak të KfW-së. Konsulenti mund ta zgjidhë kontratën, nëse pagesat që i takojnë atij nuk merren brenda 60 ditësh kalendarike nga data e caktuar. Zgjidhja lejohet vetëm nëse Konsulenti ka dorëzuar një letër kujtese me shkrim brenda 30 ditësh pas skadimit të afatit të mësipërm dhe nëse shumat e papaguara nuk paguhen brenda 30 ditëve të ardhshme.

Nëse kontrata zgjidhet pa asnjë faj të Konsulentit, ai ka të drejtën e pagesës deri në datën e zgjidhjes së kontratës. Konsulenti mund të kërkojë rimbursim të të gjitha kostove të shkaktuara deri në atë datë dhe kompensim për të gjitha humbjet dhe dëmet e shkaktuara nga zgjidhja e kontratës. Nëse kontrata zgjidhet për faj të Konsulentit, Klienti ka të drejtën të kërkojë kompensim për dëmet. Pas zgjidhjes së kontratës, shërbimet e konsulencës duhet të përfundojnë shpejt dhe me kujdesin dhe angazhimin e duhur. Raportet, draftet dhe dokumentet e tjera të plotësuara deri në atë datë duhet t'i dorëzohen Klientit pa vonesë.

7.5 Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kontrata e konsulencës duhet të përcaktojë se cili legjislacion zbatohet në kontratë. Ajo duhet të përmbajë edhe një klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet më mënyrë miqësore, palët do të kërkojnë ndërmjetësim para fillimit të procedimeve gjyqësore. Këto procedime ndjekin rregullat e gjykatave ndërkombëtare të arbitrazhit.

7.6 Gjuha e kontratës

Kontratat e konsulencës mund të hartohen në gjuhën gjermane, angleze, frënge, spanjolle ose portugeze.

7.7 Sigurimi

Kontrata e konsulencës duhet të ofrojë sigurimet e duhura për personelin dhe pajisjet e përdorura. Zakonisht, Konsulentit i kërkohet të përfitojë sigurime për zhdëmtimin e përshtatshëm profesional, sigurime personale dhe sigurime për dëmet e shkaktuara ndaj pajisjeve dhe makinerive të prokuruara nga projekti dhe sigurime gjithëpërfshirëse dhe përgjegjësie për mjetet e blera për projektin.

7.8 Tatimi i shërbimeve të konsulencës

Kontrata e konsulencës mund të përcaktojë nëse Konsulenti dhe personeli i punësuar nga ai përjashtohen nga taksat, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera zyrtare në vendin e Klientit. Në përgjithësi, pagesa e Konsulentit përjashtohet nga këto taksa dhe detyrime, siç përjashtohen edhe pagat e personelit të punësuar prej tij. Pajisjet e importuara nga Konsulenti, si dhe mallrat dhe objektet shtëpiake për përdorim personal nga personeli i tij (pajisjet bazë) zakonisht përjashtohen nga detyrimet doganore. Nëse nuk ndodh përjashtimi nga taksat, detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera zyrtare, atëherë duhet rënë dakord se Klienti do ta rimbursojë Konsulentin për të gjitha shumat e paguara për këta zëra.

7.9 Deklarata e pranimit të përgjegjësisë

Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë (shihni shtojcën 4), e paraqitur gjatë procesit të parakualifikimit ose me dorëzimin e propozimit nga ofertuesi i suksesshëm, bëhet pjesë përbërëse e kontratës së konsulencës. Në këtë Deklaratë të Konsulentit deklarohet se punonjësit dhe nënkontraktuesit e tij nuk janë përfshirë dhe nuk do të përfshihen në asnjë formë të sjelljes korruptive dhe se do të pajtohen me standardet sociale minimale ("standardet bazë të punës") të miratuara nga vendi dhe se nuk janë përfshirë në asnjë listë sanksionesh dhe se ai do t'i raportojë menjëherë Klientit dhe KfW-së në një rast të tillë. Nëse Deklarata e Pranimit të Përgjegjësisë shkelet gjatë zbatimit të marrëveshjes, KfW-ja autorizohet të ndërmarrë masat e përcaktuara në paragrafin 1.09.

SHTOJCA 8
SHTESA 1

Modeli i obligacioneve të parapaguara

Adresa e garantuesit: …
……
…….
……..
Adresa e marrësit (Klienti): ….
……
……..
……..
Në datën ..... ju nënshkruat me (emri dhe adresa e plotë)
.....
...……..
("Kontraktuesi") një Kontratë për …….....…
(projekti, objekti i Kontratës) me çmimin prej
..... .

Sipas dispozitave të kontratës, Kontraktuesi merr një pagesë paraprake në shumën e ……
.....e barabartë me ……. %
të vlerës së kontratës, si pagesë paraprake.
Ne, të nënshkruarit ……..
(banka), heqim dorë nga të gjitha kundërshtimet dhe pretendimet sipas Kontratës së lartpërmendur dhe garantojmë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pavarur të paguajmë pas marrjes së kërkesës suaj të parë me shkrim, çdo shumë paradhënie ndaj Kontraktuesit, deri në
.....
(me fjalë…….)
kundrejt deklaratës suaj me shkrim që Kontraktuesi ka dështuar të zbatojë Kontratën e lartpërmendur.
Kjo garanci hyn në fuqi menjëherë sapo pagesa paraprake të kreditohet në llogarinë e Kontraktuesit.
Kjo garanci reduktohet proporcionalisht në mënyrë automatike, në përputhje me pagesat e kryera.
Në rast të ndonjë pretendimi sipas kësaj garancie, pagesa i bëhet KfW-së, Frankfurt am Main, BIC: KFWIDEFF, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, për llogari të (Klienti/Agjencia e Zbatimit të Projektit/Blerësi).
Kjo garanci skadon jo më vonë se .....,
datë në të cilën ne duhet të kemi marrë çdo pretendim nëpërmjet shkresave ose telekomunikimit të koduar.
Nënkuptohet që ju do të na ktheni këtë garanci me skadimin ose pas shlyerjes së shumës totale që pretendohet në këtë dokument.

....

Vendi, data Garantuesi

SHTOJCA 8
SHTESA 2

Model i obligacioneve të mirëmbajtjes
Adresa e garantuesit: …
……
…….
……..
Adresa e marrësit (Klienti): ….
……
……..
……..

Në datën..... ju nënshkruat me (emri dhe adresa e plotë)
.....
.....("Kontraktuesi") një Kontratë për
..... (projekti, objekti i
Kontratës) me çmimin prej .....

Sipas dispozitave të kontratës, Kontraktuesi përfiton një shumë prej
.....,
të barabartë me ……. % të vlerës së kontratës, si pagesë përfundimtare.
Ne, të nënshkruarit ……..
(banka) heqim dorë nga të gjitha kundërshtimet dhe pretendimet sipas Kontratës së lartpërmendur dhe garantojmë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pavarur të paguajmë me marrjen e kërkesës suaj të parë me shkrim, një shumë, deri në
.....

(me fjalë…….)
kundrejt deklaratës suaj me shkrim që Kontraktuesi ka dështuar të zbatojë Kontratën e lartpërmendur.
Në rast të ndonjë pretendimi sipas kësaj garancie, pagesa i bëhet KfW-së, Frankfurt am Main, BIC: KFWIDEFF, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, për llogari të (Klienti/Agjencia e Zbatimit të Projektit/Blerësi).
Kjo garanci skadon jo më vonë se .....,
datë në të cilën ne duhet të kemi marrë çdo pretendim nëpërmjet shkresave ose telekomunikimit të koduar.
Nënkuptohet që ju do të na ktheni këtë garanci me skadimin ose pas shlyerjes së shumës totale që pretendohet në këtë dokument.

....
Vendi, data ..... Garantuesi

SHTOJCA 9
INFORMACION PËR KONTRATAT ME PAGESË TË VETME

Elementet e përgjithshme

1. Klienti, në bashkërendim me KfW-në, mund të bjerë dakord me Konsulentin për pagesën bazuar ose në punën aktuale të kryer, ose në pagesën e vetme. Pagesa bazuar në punën aktuale të kryer rekomandohet, nëse puna që duhet kryer nga Konsulenti nuk është përcaktuar përfundimisht në kohën e bisedimeve kontraktuese, për shembull, detyrat e menaxhimit të ndërtimit. Për pagesën e vetme duhet të bihet dakord nëse janë përcaktuar qartë shërbimet që do të ofrohen dhe afati brenda të cilit do të ofrohen.

2. Ofertuesit duhet të njoftohen në kohën e duhur për mënyrën se si do të paguhen shërbimet dhe jo më vonë se së bashku me kërkesën për tendera.

Avantazhet e pagesës së vetme

3. Sipas kontratës me pagesë të vetme, shpërblimi dhe shpenzimet materiale shlyhen nëpërmjet një pagese të vetme. Faturat e veçanta që verifikojnë afatin e caktimit të ekspertëve nuk janë më të nevojshme. Krahas thjeshtimit të procedurës së shlyerjes, ky përcaktim është bërë për t'u ofruar Konsulentëve fushë të gjerë veprimi për kryerjen e detyrës, duke nxitur në këtë mënyrë ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe aftësinë e tyre krijuese novatore, si dhe për të theksuar orientimin e kontratës ndaj rezultateve.

4. Mënyra e pagesës së vetme duhet aplikuar, nëse shërbimi që do të ofrohet është përcaktuar qartë dhe Konsulenti mund të vendosë vetë se si t'i përmbushë këto detyra. Metoda e pagesës së vetme përshtatet fillimisht për studime, planifikim të detajuar dhe detyra të ngjashme të përcaktuara qartë. Risku ekonomik që i shkaktohet Konsulentit nëpërmjet metodës së pagesës së vetme nuk duhet të çojë në shpërblime të papërshtatshme me rrezik të lartë.

Veçantitë e përgatitjes së kontratave me pagesë të vetme

5. Sipas kontratave me pagesë të vetme, nuk është më e nevojshme që të rekomandohet personel për çdo pozicion, si dhe plotësimi i CV-ve të tyre; mjafton që të kërkohet CV-ja e personelit kyç në propozimin teknik. Vetëm ato vlerësohen. Fakti se cilët punonjës kyç janë të nevojshëm për kryerjen e detyrës duhet specifikuar në termat e referencës. Vetëm zëvendësimi i personelit kyç kërkon miratimin e Klientit dhe KfW-së. Ndryshimet në planifikimin e detyrës nuk kërkojnë miratim për aq kohë sa ato nuk reduktojnë periudhën e detyrës së personelit kyç. Konsulenti është përgjegjës që t'i përmbahet afatit dhe të kryejë punën e rënë dakord në kontratë.

6. Pagesat sipas kontratës së konsulencës duhen kryer në bazë të progresit të shërbimeve; me arritjen e shumës prej 70% të pagesës së kontraktuar, ato duhen kryer në bazë të shërbimeve të dokumentuara që lidhen me fazat specifike më të rëndësishme të projektit.

7. Nënshkrimi i kontratës me pagesë të vetme nuk përjashton pagesën e produkteve të rimbursueshme për disa punë ndihmëse (si shpimi gjeoteknik), qëllimi i të cilave nuk është i njohur në kohën nënshkrimit të kontratës, me dorëzimin e faturës përkatëse.

SHTOJCA 10
LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTIMEVE DHE FJALORTHI

Raport vlerësimi	Shihni përkufizimet në paragrafët 2.12 dhe 2.32.
BOT	Ndërto-Opero-Transfero; termi përdoret si sinonim me termat BOOT dhe BOO.
Klienti	Shihni përkufizimin te hyrja.
Kontraktimi	Procedurat për dhënien e një kontrate dhe rezultatin e tyre. Procedurat parashikojnë publikimin fillestar, kualifikimin, përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave, dhënien e kontratës dhe njoftimin e ofertuesve të pasuksesshëm.
Standardet bazë të punës	Standardet bazë të punës përcaktojnë standardet minimale të rëna dakord për të drejtat e punonjësve. Ndër të tjera, ato mbulojnë punën e detyruar dhe punën shfrytëzuese të fëmijëve dhe kërkojnë të mbrojnë lirinë e punonjësve për asociim dhe lirinë e tyre nga diskriminimi. Agjencia drejtuese është Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). Për detaje të mëtejshme për standardet bazë të punës dhe listën që tregon se cilat vende kanë ratifikuar standarde të caktuara, vizitoni: http//www.ilo.org.
Afati për dorëzimin e ofertave	Numri i ditëve kalendarike ndërmjet datës së lëshimit të dokumenteve të tenderit dhe datës kur do të dorëzohen ofertat.
Porta e zhvillimit	Një listë e ftesave aktuale për ofertë është e disponueshme në: http://www.dgmarket.com.
Prokurimi i drejtpërdrejtë	Kontratat lidhen drejtpërdrejt, pa ofertim konkurrues.
FIDIC	Federata e Ndërkombëtare e Inxhinierëve dhe Konsulentëve (http://www.fidic.org). "Libri i kuq" lidhet me punimet mbulon impiantin ndërtimore, "libri i verdhë" elektrik dhe mekanik dhe projektet e projektim-ndërtimit, dhe "libri i gjelbër" përdoret për projekte të vogla, p.sh., projekte që reklamohen në nivel vendor. "Libri i argjendtë" për projekte të gatshme "me çelësa në dorë" është vetëm për projekte me rëndësi të ulët të financuara nga FC-ja, për shkak të mungesës së një konsulenti të pavarur.
Bashkëpunimi Financiar (FC)	Shihni përkufizimin te hyrja (kutia)
GTAI	Agjencia e qeverisë gjermane për nxitjen e tregtisë dhe investimeve. Adresa: Tregtia dhe Investimi Gjerman[26] Villemombler Strasse 76

[26] Emri i plotë: Tregtia dhe Investimi Gjerman – *Gesellschaft für Außenwirtschaft und Standortmarketing mbH*.

	53123 Bon Gjermani Tel: +49 (228) 24993 - 374 or 377 Faks: +49 (228) 24993 - 446 Email: kfw-tender@gtai.de Internet: www.gtai.de
Udhëzime për prokurimin e mallrave, punëve dhe Shërbimeve të ngjashme	Të disponueshme në pesë gjuhë në internet sipas udhëzimeve/kontratave: https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Development-Bank/Publications-Videos/Publication-series/
ICC	Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë Faqja e internetit: http://www.icc-deutschland.de
IFI	Institucionet financiare ndërkombëtare, p.sh., Banka Botërore, Banka Aziatike për Zhvillim, Banka Afrikane për Zhvillim, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Ndër-amerikane përZhvillim,
Fletëpalosje për disbursimin e fondeve të bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim	E disponueshme në pesë gjuhë në internet sipas udhëzimeve/kontratave: https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Development-Bank/Publications-Videos/Publication-series/
Vendi partner	Shteti që është marrës i huas ose grantit të FC-së ose shteti ku është vendosur partneri joqeveritar.
Periudha e vlefshmërisë	Periudha gjatë së cilës ofertat mbeten detyruese; kjo mbulon të njëjtën periudhë si garancia.
Agjencia e Zbatimit të Projektit	Organizata në vendin partner që është përgjegjëse për zbatimin e projektit; kjo organizatë është zakonisht edhe Klienti.
Dokumentet standarde të ofertimit	Dokumentet standarde të ofertimit të IFI-ve për publikimin e ftesës për tender, procedurat e kontraktimit dhe kontratat. Për të shkarkuar dokumentet vizitoni: http://www.worldbank.org/ ose http://www.adb.org/

VENDIM
Nr. 427, datë 11.7.2018

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 3.1 HA, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "PIETRA NESLI" SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT RANOR SILICOR NË OBJEKTIN "ZOGASI", BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 3.1 ha, që do të përdoret nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit ranor silicor në objektin "Zogasi", Bashkia Skrapar, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore që zvogëlohet në volum dhe hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik, si dhe harta topografike, me koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore e kullosore dhe të investimeve të kryera në vite në sipërfaqen, objekt minerar, të paguhen nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Skrapar, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 3.1 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Bashkinë Skrapar.

4. Bashkia Skrapar dhe shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi nga kategoria "tokë e zënë pyjore" dhe ta regjistrojë në kategorinë "tokë e zënë, objekt i aktivitetit minerar".

7. Me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullosor publik të Bashkisë Skrapar.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Skrapar dhe shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

BASHKIA SKRAPAR

LISTA E NGASTRAVE DHE E N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQET PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR
TË SHOQËRISË "PIETRA NESLI" SHPK

Nr.	*ID pronës*	*Ekonomia Pyjore / Kullosore*	*Ngastra n/ngastra*	*Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/ kullosor HA*	*Përdorimi territorit*
1	*2*	*3*	*4*	*5*	*6*
	BR32 00 064a	Sijovë-Guhak	64 a	2.8	shkurre
	BR32 00 064b	Sijovë-Guhak	64 b	0.3	shkurre
GJITHSEJ				**3.1**	

HARTA TOPOGRAFIKE

ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E ZONES SE KERKUAR
(*EKONOMIA PYJORE SIJOVE-GUHAK) SHKALLA 1:25000



PERGATITI:
EMRI : ING.EDMOND SINJARI
LIC.T.0528/2, DT.18.11.2016

DATA E PERGATITJES
23 . 01. 2018

SHENIME:

- SIPERFAQJA E KERKUAR TOTALI 0.031KM².
- EKONOMIA PYJORE SIJOVE - GUHAK.

■ PAS. 89 a --SIP.0.028KM²

■ PAS. 90 a --SIP.0.003KM²

TABELA E KOORDINATAVE

PIKA	X	Y
1	44 85 125	44 38 225
2	44 85 250	44 38 140
3	44 85 360	44 38 350
4	44 85 265	44 38 410

VENDIM
Nr. 428, datë 11.7.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" (ARË) NË "TOKË URBANE" (TRUALL), TË PASURIVE NR. 241/12, ME NR. KADASTRAL 237 E 238 DHE NR. 241/14, ME NR. KADASTRAL 239, NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ, FSHATI KAMENICË, BASHKIA KORÇË, PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË HIDROCENTRALIT "KAMENICË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall), të pasurive nr. 241/12, me nr. kadastral 237 e 238 dhe nr. 241/14, me nr. kadastral 239, Njësia Administrative Mollaj, fshati Kamenicë, Bashkia Korçë, për ndërtimin e objekteve të hidrocentralit "Kamenicë".

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin e kategorisë të resursit, nga "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall).

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 429, datë 11.7.2018

PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET BASHKIMIT TË SHOQËRIVE, PËR DHËNIEN ME KONCESION/ PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN, TRANSFERIMIN E AEROPORTIT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, dhe në vijim të nenit 15 të rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, miratuar me vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 8% (tetë për qind) të pikëve, që i jepet bashkimit të shoqërive "Kastrati" sh.a. dhe "T.M.D. *Systems* LTD", për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën për dhënien me koncesion/partneritet publik privat për projektin e rehabilitimit, të operimit, transferimit të Aeroportit të Kukësit.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë